

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5566  
E hënë, 3 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

## Sot fillon viti i ri shkollor

Me rastin e vitit të ri shkollor 2018/2019 në Kosovë, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka kërkuar nga nxënësit të angazhohen për nxënien e dijes në këtë vit shkollor, kurse nga mësimdhënësit ka kërkuar angazhim maksimal në punë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

### A MUND TË JETË KY PLANI I ARDHSHEM PËR KOSOVËN?



F. 11

Nga Bedri ISLAMI

### VESELI: MITROVICA NUK DO TË JETË PJESË E PAZAREVE

F. 3

### MBI 200 THASË ME MBETURINA LARGOHEN NË MERDARE

F. 7

## EKONOMI

### BALIJA: KOSOVA PO SHËNON RËNIE TË INVESTIMEVE TË HUAJA

F. 8

### PAGË MË TË ULËT SE MINIMALJA

F. 8

## KULTURË

### KONTRIBUTI ATDHETAR I GRUAS SHOQIPTARE PARË NËN PRIZMIN E STUDIMEVE TË PROF. DR. SABILE KEÇMEZI-BASHA

F. 13

Prof. dr. Teuta  
SHALA - PELI



## SPORT

### FLAMURTARI VALON NË ELITE

F. 14

### BALLKANI MIRATON DORËHEQJEN E SHOTANIT

F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERAND STAVILECI

FAQE 4-5

## Seanca e ftuar nga opozita, absurde

### - Me debat parlamentar opozita po e legjitimon çështjen e ndarjes së Kosovës



Këshilltari i kryeparlamentarit Kadri Veseli dhe anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, e ka vlerësuar absurde seancën e jashtëzakonshme parlamentare të thirrur për të martën nga opozita për të diskutuar për dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se është e pafalshme për opozitën që ta shtrojë për debat ndarjen e Kosovës në Kuvend. Sipas tij, subjektet opozitare po e legjitimojnë këtë temë kur kjo çështje nuk është temë e dialogut Kosovë - Serbi. Stavileci ka deklaruar se është e panevojshme që Kuvendi të nxjerrë rezolutë për mbrojtjen e integritetit

territorial të Kosovës kur atë e garanton Kushtetuta e Republikës. Duke folur për idenë e presidentit për korrigjimin e kufirit me Serbinë, përmes të cilit synohet që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës, ai ka thënë se PDK-ja do të ishte e lumtur nëse në fund të këtij procesi negociator Lugina do t'i bashkohet Kosovës

KËSHILLI I PËRGGJITHSHËM I LËVIZJES VETËVENDOSJE KA  
MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS

## Kurti paralajmëron protesta

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se shteti i Kosovës është duke kaluar çaste të vështira. Në këtë kontekst ai ka kërkuar mobilizim qytetar për protestat që do të mbahen në ditët dhe javët në vijim për ta kundërshtuar idenë e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas Kurtit, ideja dhe diskutimi për shkëmbim territorial që po quhet korrigjim kufiri sjell ndarjen e Kosovës dhe ndarjen e Kosovës Lindore

FAQE 7



### Konfiskohen mallra të falsifikuara në vlerë prej 436 mijë eurosh

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Zaevi e Vuçiçi flasin edhe për dialogun Kosovë - Serbi

**PRESHEVË, 2 SHTATOR** - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka diskutuar të dielën me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, edhe për çështjen e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit zyrtar. Zaev konsideron se një zgjidhje mes Serbisë e Kosovës është e rëndësishme për

perspektivën e evropiane dhe, sipas tij, duhet të përkojë me përmirësimin e jetës së serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë duke sjellë paqe. "Të gjithë liderët në rajon janë të bashkuar në një qëllim të përbashkët të paqes", ka thënë Zaevi në Preshevë në Serbinë Jugore, në një konferencë të për-

bashkët për medie me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiçi. "Besoj se duhet gjetur një zgjidhje në mes të Serbisë dhe Kosovës dhe ne e mbështesim plotësisht dhe shpresojmë se do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur", raporton 'Klankosova'. "Për shkak se ajo është e rëndë-

sishme për Serbinë dhe perspektivën e saj evropiane dhe të rajonit në përgjithësi", ka thënë tutje Zaev. Kurse presidenti serb, Aleksandër Vuçiçi, ka thënë se i është mirënjohës kryeministrit Zaev për qëndrimin e tij ndaj dialogut me Prishtinën. Zoran Zaev dhe Aleksandër Vuçiçi



u takuan të dielën për të diskutuar për kalimin e unifikuar të kufirit midis Serbisë dhe Maqedonisë.

# Fushata për referendumin në Maqedoni, e fokusuar në daljen në votim

Janë 30 parti politike në koalicion, të kryesuar nga LSDM e kryeministrit Zoran Zaev dhe BDI-së të drejtuar nga Ali Ahmeti, që bashkërendojnë aktivitetet për t'i bindur qytetarët ta mbështesin referendumin që do të mbahet më 30 shtator



**SHKUP, 2 SHTATOR** - Njohësit e çështjeve politike thonë se fushata për referendumin në esencë është e bazuar në fushatën për arritjen e pragut të daljes në votime mbi 50 për qind, që do të thotë edhe legjitimim i marrëveshjes në mes të Maqedonisë dhe Greqisë për ta zhbllokuar procesin e integrimi euroatlantike për Maqedoninë.

Në një rën anë, 30 parti politike në koalicion të kryesuar nga Lidhja Social Demokrate e kryeministrit Zoran Zaev dhe Bashkimit Demokratik për Integrim të drejtuar nga Ali Ahmeti, bashkërendojnë aktivitetet e tyre për t'i bindur qytetarët që ta mbështesin referendumin që do të mbahet më 30 shtator.

Nga ana tjetër, 30 organizata, mes të cilave edhe parti politike, janë bashkuar ta bojkotojnë referen-

dumin duke zhvilluar fushatë përmes "shtabit të krizës me thirrje për bojkot". Ndërkohë që partia maqedonase në opozitë, e cila është shprehur se nuk e përkrah marrëveshjen Maqedoni - Greqi, duke e cilësuar të dëmshme për interesat e shtetit, nuk ka bërë të ditur nëse do ta ftojë anëtarësinë e saj që ta bojkotojë referendumin apo të dalë të votojë kundër.

Pjesëmarrja e VMRO DPMNE-së të ish-kryeministrit Nikolla Gruevski llogaritet si vendimtare për arritjen e pragut në referendumin.

Darko Aleksov, kryetar i asociacionit qytetar "MOST", që për 16 vjet monitoron proceset zgjedhore në Maqedoni, për "Radion Evropa e Lirë" thotë se pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje përmes votës paraqet një shtyllë shumë të rëndësishme për zhvil-

limin e demokracisë. "Ajo çka mund ta themi sot këtu, është se u bëjmë apel qytetarëve të informohen mirë dhe ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës për shkak se si qytetarë në këtë shtet ne shfrytëzojmë përfitimet dhe të drejta të caktuara. Ashtu siç duam t'i shfrytëzojmë privilegjet dhe përfitimet, gjithashtu duhet t'i zbatojmë edhe obligimet tona", tha ai. "Një prej obligimeve është të jemi qytetarë aktivë dhe të marrim pjesë në procesin e vendimmarrjes, e ky është një vendim shumë i rëndësishëm prej të cilit varet se si do të

zhvillohet shteti në 5 deri në 10 vjetet në vijim", tha Aleksov.

Njohësit e çështjeve juridike thonë se çdokush ka të drejtë ta shprehë qëndrimin e vet për ose kundër referendunit, megjithatë theksojnë se çdo organizim për bojkotin e referendunit dënohet me ligj. "Thirrja për bojkot dhe organizimi i bojkotit, sigurisht se paraqet vepër penale nëse ajo bëhet nga subjekte të organizuara politikisht ose në çfarëdo forme tjetër", thonë ata. "Ndërsa, shprehja individuale e mendimit pa organizim të bojkotit paraqet shprehje të mendimit individual

dhe ajo nuk sanksionohet", thotë Naser Ziberi, ekspert për çështje juridike.

Ndërsa Darko Aleksov, duke komentuar paraqitjen e mendimeve të ndryshme në opinionin rreth asaj nëse organizimi i qytetarëve për ta bojkotuar referendumin konsiderohet vepër penale ose jo, vlerëson se kjo çështje duhet ndjekur me vëmendje, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me ushtrimin e çfarëdo lloj presioni për ta bojkotuar referendumin. "Në Kodin Penal është e precizuar se cila është ajo vepër penale për pengimin e votimeve - kjo është gjatë kërcënimit serioz, gjatë përdorimit të forcës, përdorimit të armës dhe në mënyra të tjera. Gjithë tjetra është propagandë", tha ai. "Nëse nuk e ka asnjërin prej këtyre elementeve, atëherë nuk ka vepër penale. Por, nëse ka elemente të këtyra, dhe nëse ka presione, dhe gjithë ato gjërat shoqëruese, atëherë shpresojmë se institucionet në mënyrë adekuate do të reagojnë dhe do t'i adresojnë këto dukuri", thotë Aleksov.

## Kuvendi i Shqipërisë u kthehet seancave



**TIRANË, 2 SHTATOR** - Pas një qetësie prej më shumë se 4 javësh, politika pritet t'i rikthehet zhurmës sot (e hënë). Kreu i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka firmosur tashmë urdhrin për ta nisur sesionin e ri parlamentar të hënën e parë të shtatorit, siç e kërkon edhe Kushtetuta. Seanca e parë plenare, që është vetëm ceremoniale, pritet të nisë rreth orës 17:00. Por, në selitë e partive politike kryesore lëvizjet pritet që të nisin që në

orët e para të ditës. Socialistët do ta nisin punën herët, me një mbledhje Kryesie të parashikuar për në orën 9.00 të mëngjesit. Në fokus janë përgatitjet për garën e ardhshme elektorale.

Në këtë sens pritet që Kryesia ta zyrtarizojë thirrjen e Asamblesë Kombëtare për të premtën e 7 shtatorit. Në këtë mbledhje kryeministri Rama do të vendosë përfundimisht nëse do të ketë ndryshime në kabinetin qeveritar,

ndonëse burimet nga PS-ja tregojnë se ka pak gjasa që kjo të ndodhë.

Ndërsa në selinë blu Lulzim Basha do t'i takojë aleatët e vet dhe do ta mbledhë grupin parlamentar të PD-së rreth orës 10.00. Ai nuk ka pranuar të tregojë cila do të jetë qasja e demokratëve me Parlamentin, institucion me të cilin selia blu ka pasur një marrëdhënie të kushtëzuar gjatë muajve të fundit.

## Pacolli takon homologen kroate Pejçinoviç-Buriq

**PRISHTINË, 2 SHTATOR** - Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka takuar homologen e vet kroate, Marija Pejçinoviç-Buriq. Pacolli ka bërë me dije se

do t'i avancojnë raportet Kosovë - Kroaci, duke organizuar edhe një forum ekonomik. "Takim shumë miqësor me ministren e

Jashtme kroate Marija Pejçinoviç-Buriq. Raportet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve tona do t'i avancojnë ekonomikisht duke organizuar

forumin ekonomik për ta fuqizuar edhe më tej lidhjen ndërmjet Kroacisë dhe Kosovës", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".



Është mbajtur tryeza me temë "Faza finale e dialogut Kosovë - Serbi"

# Veseli: Mitrovica nuk do të jetë pjesë e pazareve



Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se Mitrovica nuk do të jetë asnjëherë pjesë e pazareve. Sipas tij, Mitrovica ka qenë dhe do të mbetet zemra dhe krenaria e Kosovës. Këto komente Veseli i ka bërë të dielën në tryezën me temë "Faza finale e dialogut Kosovë - Serbi"

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë të dielën se Mitrovica do të jetë përherë e Kosovës dhe nuk do të bëhet kurrë pjesë e asnjë pazari. "Ndoshta ju ka ra rasti kohët e fundit të dëgjoni zëra të ndryshëm që flasin se si Mitrovica mund të jetë pjesë e pazareve për këmbim territoresh me Serbinë. Besoni, këta zëra janë të njerëzve e qarqeve që nuk ia duan të mirën as

Mitrovicës e as Kosovës. Nuk e njohin Mitrovicën, nuk e duan ose aq shumë e njohin dhe e duan vetëm për interesa të kufizuara jo në interes të Mitrovicës, as të mitrovicasve. Janë zëra që nxisin panik tek qytetarët dhe në këtë mënyrë u shërbejnë qëllimeve të këqija, forcave kundër Kosovës. Janë zëra prorusë, janë zëra proserbë, të mbushur plot patriotizëm. Por Mitrovica kurrë, ama bash kurrë nuk do të preket. Mitrovica ka qenë dhe përgjithmonë ka për të mbetur zemra dhe krenaria e Kosovës", ka deklaruar Veseli

në tryezën me temë "Faza finale e dialogut Kosovë - Serbi", e organizuar nga "RTV Mitrovica". Ai ka thënë se ka ardhur për t'i takuar qytetarët e Mitrovicës, për t'ua treguar edhe një herë vendosmërinë e tij se shteti i Kosovës do të mbrohet dhe zhvillohet me vepra dhe jo me fjalë e gënjeshtër. Veseli ka premtuar se në Mitrovicë do të ketë investime të mëdha, duke përmendur në këtë drejtim një projekt të ideuar nga ai që parasheh investime në të dyja anët e lumit.

Po ashtu, Veseli ka folur edhe për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të opozitës, duke thënë se kjo iniciativë është absurde, tragjike dhe manipuluese. "Është tragjike sepse këto forca opozitare në institucionin më të lartë të vendit për herë të parë e vënë në pyetje tërësinë tonë territoriale, do të thotë brenda institucionit më të lartë të Kosovës e vënë në

pyetje ndarjen e Kosovës. Ky është një precedent tepër i rrezikshëm për shtetin tonë. Por, është edhe manipuluese sepse nëse kemi ardhur në ditë që integriteti territorial i Kosovës të mbrohet veç me rezolutë, kur flitet për Preshevën, për bashkimin kombëtar, atëherë kjo është shumë manipuluese dhe jo e sinqertë nga ana e opozitës. Unë ju pyes juve dhe tërë shqiptarët, kush më së shumti ka folur kundër Kushtetutës së vendit dhe shtetit të Kosovës për efekte patriotizmi manipulues sesa kjo opozitë që ka iniciuar tani debatin parlamentar, kinse për ruajtjen e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës?", është shprehur Veseli. Ai ka thënë se kauzat e rreme nuk e mbrojnë shtetin, përkundrazi e rrezikojnë atë. Sipas Veselit, shteti mbrohet duke respektuar Kushtetutën dhe duke vënë interesin e shtetit përpara interesave partiake.

Veseli u ka bërë thirrje partive

opozitare të mos diskutojnë për ndarje, por vetëm për bashkim të Luginës së Preshevës. "I thërras kolegët e partive opozitare për racionalitetin e tyre. Lëvizja Vetëvendosje duhet ta ndalë rrënimin e shtetit tonë. Ftoj LDK-në të distancohet nga ato nënshkrime, mos të flasim të martën për ndarje, mos t'i futet avazit të Vetëvendosjes", ka theksuar Veseli, duke shtuar se nëse duhet të bisedohet diçka të martën, është që LDK-ja të distancohet nga nënshkrimi i marrëveshjes së asociacionit. "Asociacioni me kompetenca ekzekutive do të jetë i papranueshëm. Për këtë të jeni të sigurt, edhe për arsye se është më e rrezikshme se vetë ndarja. Aktualisht elementi faktik të cilin e ka Republika e Kosovës është veç asociacioni me kompetenca ekzekutive. Kjo është ajo e cila duhet të evitohet si rrezik. Nuk është as ndarja, as biseda ndaj Preshevës", ka theksuar Veseli.

## Në Prishtinë u mbajt mesha në kuadër të festës "Shën Nënë Tereza 2018"

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Të dielën në Katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë është mbajtur aktiviteti i parë i Ipeshkvisë së Kosovës në kuadër të Festës "Shën Nënë Tereza 2018". Në kuadër të kësaj

festë që përfshinë disa aktivitete, është mbajtur mesha në të cilën morën pjesë një numër i madh i besimtarëve katolikë.

Vikari Don Lush Gjergji në fjalimin kryesor u bëri thirrje atyre

të luten për shpirtin e Shën Terezës dhe ta përcjellin veprën e saj, dashurinë që ajo pati për popujt dhe njeriun. Ai ka thënë se Shën Tereza dëshmon çfarë do të thotë të besohet dhe se pa

dashurinë që ajo dhuronte jeta nuk do të kishte kuptim. Don Lush Gjergji ka thënë se Shën Tereza dhe gjaku i saj janë frymëzim që thërrasin në flimj dhe vëllazërim njerëzor.



Flet për "Epokën e re", Blerand Stavileci

# Seanca e ftuar nga



## - Me debat parlamentar opozita po e legjitimon çështjen e ndarjes së Kosovës

Këshilltari i kryeparlamentarit Kadri Veseli dhe anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, e ka vlerësuar absurde seancën e jashtëzakonshme parlamentare të thirrur për të martën nga opozita për të diskutuar për dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e pafalshme për opozitën që ta shtrojë për debat ndarjen e Kosovës në Kuvend. Sipas tij, subjektet opozitare po e legjitimojnë këtë temë kur kjo çështje nuk është temë e dialogut Kosovë - Serbi. Stavileci ka deklaruar se është e panevojshme që Kuvendi të nxjerrë rezolutë për mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës kur atë e garanton Kushtetuta e Republikës. Duke folur për idenë e presidentit për korrigjimin e kufirit me Serbinë, përmes të cilit synohet që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës, ai ka thënë se PDK-ja do të ishte e lumtur që nëse në fund të këtij procesi negociator, Lugina do t'i bashkohet Kosovës

**EPOKA E RE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Këshilltari i kryeparlamentarit Kadri Veselit dhe anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, e ka kundërshtuar seancën e jashtëzakonshme parlamentare të opozitës, e cila do të mbahet të martën, duke e cilësuar atë absurde. Ai ka thënë se këtë seancë opozita nuk e ka ftuar që të diskutohet për dialogun Kosovë - Serbi dhe arritjen e një konsensusi nacional për këtë çështje, por për të diskutuar për ndarjen e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se në këtë mënyrë opozita po e legjitimon ndarjen e Kosovës. "Seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga partitë opozitare është absurde. Ajo nuk është ftuar që aty të diskutohet për dialogun Kosovë - Serbi, që aty të diskutohet për krijimin e një konsensusi nacional për një çështje kaq të rëndësishme, që aty të diskutohet se si të krijohet një platformë e përbashkët dhe se si të dalë sa më e fuqishme Kosova në këtë përballje të fundit me Serbinë. Kjo seancë, për fat të keq, është ftuar nga opozita që aty të flitet për ndarjen e Kosovës", ka thënë Stavileci. Ai ka deklaruar se PDK-ja do të marrë pjesë në këtë seancë dhe aty do ta shprehë qëndrimin e vet. "Është e pafalshme për opozitën që ta shtrojë për debat ndarjen e Kosovës në Kuvendin e Kosovës, pra ta legjitimojë këtë temë, kur kjo çështje as nuk është temë e dialogut, as nuk ka qëllime të tilla dhe as nuk lejohet me Kushtetutë. Por, gjithsesi,

Partia Demokratike e Kosovës do të marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme të thirrur për datën 4 shtator dhe aty do t'i shprehë qëndrimet e veta", është shprehur ai.

Sipas anëtarit të Kryesisë së PDK-së, është e panevojshme të nxjerrë Kuvendi rezolutë për mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës kur atë e mbron Kushtetuta e vendit. "Është krejtësisht e panevojshme që të nxirret një rezolutë - me të cilën do të kërkohet mbrojtja e integritetit territorial të Kosovës, kur kjo çështje është e përcaktuar qartë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, them se është absurde thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme, për shkak të temës që do ta trajtojë", është shprehur Stavileci, duke shtuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta thotë fjalën e fundit për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. "Kjo është e qartë dhe është thënë vazhdimisht nga PDK-ja dhe kryetari Kadri

# opozita, absurde



shtrojë për debat ndarjen e Kosovës në Kuvendin e Kosovës, pra ta legjitimojë këtë temë, kur kjo çështje as nuk është temë e dialogut, as nuk ka qëllime të tilla dhe as nuk lejohet me Kushtetutë. Por, gjithsesi, Partia Demokratike e Kosovës do të marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme të thirrur për datën 4 shtator dhe aty do t'i shprehë qëndrimet e veta.

**"Epoka e re":** Në këtë seancë opozita dëshiron ta nxjerrë një rezolutë përmes së cilës do të kërkohet mbrojtja e integritetit territorial të vendit. Do ta përkrahë PDK-ja miratimin e kësaj rezolute?

**Stavileci:** Është krejtësisht e panevojshme të nxirret një rezolutë - me të cilën do të kërkohet mbrojtja e integritetit territorial të Kosovës, kur kjo çështje është e përcaktuar qartë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, them se është absurde thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme për shkak të temës që do ta trajtojë. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta thotë fjalën e fundit për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Kjo është e qartë dhe është thënë vazhdimisht nga PDK-ja dhe kryetari Kadri Veseli. Por, Kuvendi i Kosovës do të duhej ta miratonte një rezolutë gjithëpërfshirëse, e cila mbështet dialogun dhe shpreh qëllimet e Kosovës në këtë proces të rëndësishëm.

Dialogu Kosovë - Serbi duhet të ndodhë në mënyrë që finalja e këtij procesi ta prodhojë një marrëveshje ndërkombëtarisht obligative për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, njohjen reciproke si dy shtete të pavarura dhe sovraane, si dhe hapjen e rrugës për anëtarësimin e Kosovës në OKB, NATO dhe BE. Këto qëllime do të duhej ta bashkonin gjithë spektrin politik kosovar. Në vend se të diskutohet për ndarjen e Kosovës, siç po kërkon opozita, në Kuvendin e Kosovës do të duhej të diskutohet për platformën e përbashkët për dialogun. Opozita duhet ta thotë hapur nëse është për apo kundër dialogut. Opozita duhet ta thotë hapur nëse është për apo kundër njohjes së Kosovës nga Serbia, ulëses së Kosovës në OKB dhe përshtetimit të integriteteve euroatlantike?

**"Epoka e re":** Liderët e koalicionit qeverisës janë takuar disa

herë me presidentin e vendit për të diskutuar rreth kësaj çështje. A është arritur që koalicioni ta ketë një qëndrim unik në lidhje me idenë e presidentit të vendit për korrigjim të kufijve me Serbinë?

**Stavileci:** Qëndrimi i institucioneve të Kosovës është i qartë. Qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës, prej fillimit, ka qenë i qartë: Kosova nuk negocion për shtetësinë, sovranitetin dhe integritetin e vet territorial. Ky qëndrim është shprehur edhe në dokumentin bazë për dialogun, të hartuar nga PDK-ja dhe kryetari Kadri Veseli. Ky dokument u është dërguar të gjithë liderëve, përfshirë edhe atyre opozitarë, me kërkesë për ta shikuar dhe plotësuar së

bashku, në takime që kanë pasur synim arritjen e konsensusit nacional. Por, po e them, në vend të konsensusit, opozita ka zgjedhur ndarjen e spektrit politik, duke ngritur tema të paqena - siç është ndarja e Kosovës dhe shkëmbimi i territoreve. Dhe, krejt këtë është duke e bërë për përfitime të veta politike. Nuk është e ndershme.

**"Epoka e re":** Çfarë nëse qëndrimi i PDK-së në seancën për këtë çështje nuk do të jetë i njëjtë me partnerët e tjerë të koalicionit qeverisës. Mund ta lëvizë kjo koalicionin?

**Stavileci:** Partia Demokratike e Kosovës nuk ka qëndrim tjetër përpos atij të shprehur tash e sa kohë: Kosova nuk negocion për

shtetësinë, sovranitetin dhe integritetin e vet territorial. Nuk ka ndonjë qëndrim tjetër, pos këtij, as te partnerët e koalicionit. Përveç opozitës, askush tjetër nuk është duke folur përtej kësaj.

**"Epoka e re":** PDK-ja po e përkrah presidentin në idenë e tij për korrigjimin e kufirit me Serbinë, përmes të cilit synohet që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës. Sa besoni se kjo është e mundshme?

**Stavileci:** Kërkesa e Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën, e shprehur në referendumin e atjeshëm, është legjitime. PDK-ja do të ishte e lumtur, nëse në fund të këtij procesi negociator ajo t'i bashkohej Kosovës.

## Haradinaj rithekson përkushtimin e Kosovës për integrim në BE dhe NATO

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka theksuar se objektivi kryesor i Kosovës mbetet integrimi në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO. Këto deklarata Haradinaj i shpalosi në Forumin e Dubrovnikut, ku po diskutohet për të ardhmen e

Ballkanit Perëndimor, Evropës dhe Mediteranit. "Jemi duke punuar me përkushtim për qeverisje transparente dhe llogaridhënëse, fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në të njëjtën kohë po punojmë në Agjendën e Reformave

Evropiane, ERA 2", ka thënë Haradinaj. Më tej, Haradinaj ka theksuar se Kosova është duke punuar për ta shndërruar FSK-në në forcë të armatosur, sipas standardeve të NATO-s, duke synuar bashkëpunimin me vendet aleate në forcimin e stabilitetit në rajon, Evropë dhe në botë.



Veseli. Por, Kuvendi i Kosovës do të duhej ta miratonte një rezolutë gjithëpërfshirëse, e cila mbështet dialogun dhe shpreh qëllimet e Kosovës në këtë proces të rëndësishëm", ka thënë Stavileci.

**"Epoka e re":** Z. Stavileci, opozita ka thirrur një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për dialogun me Serbinë. Cili është qëndrimi i PDK-së për këtë seancë?

**Stavileci:** Seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga partitë opozitare është absurde. Ajo nuk është ftuar që aty të diskutohet për dialogun Kosovë - Serbi, që aty të diskutohet për krijimin e një konsensusi nacional për një çështje kaq të rëndësishme, që aty të diskutohet se si të krijohet një platformë e përbashkët dhe se si të dalë sa më e fuqishme Kosova në këtë përballje të fundit me Serbinë. Kjo seancë, për fat të keq, është ftuar nga opozita që aty të flitet për ndarjen e Kosovës. Është e pafalshme për opozitën që ta

# Mbi 200 thasë me mbeturina largohen në Merdare

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**MERDARE, 2 SHTATOR** - Dhjetëra vullnetarë të "Let's Do It Kosova" kanë larguar mbi 200 thasë me mbeturina përgjatë rrugës që të çon tek pika kufitare në Merdare. Gjatë aksionit të së dielës që filloi në orën 11:00, ndërsa zgjati deri në orën 13:00, mbeturinat u larguan nga rreth një kilometër

e rrugës. Pjesa e papastuar në aksionin e sotëm do të pastrohet në aksionin e madh të 15 shtatorit.

Drejtori ekzekutiv i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, ka thënë se pasqyra e parë që sapo hyjmë në një shtet është ajo që na del përpara, andaj nuk duhet të lejojmë pamje të tilla. "Qytetarët tanë nuk janë të tillë. Këtë po e bazoj në faktin se kujdesemi mirë për pronat

tona, por jo edhe për pronat publike. Shteti i cili është pronar legjitim i këtyre pronave duhet të kujdeset dhe të marrë masa kur ato dëmtohen. Dua ta shfrytëzoj këtë ditë për t'i ftuar edhe institucionet që të jenë të kujdesshme ndaj ambientit, siç është rasti me këtë vend këtu, ku duhet të vendosen shporta të mbeturinave", ka thënë ai. Hasanaj ka bërë me dije se tashmë ka filluar edhe aksioni i

madh për pastrimin e Kosovës. "Jemi dëshmitarë që Qeveria tashmë ka krijuar Task Forcën për ambientin. Më 15 shtator, kur do të mbahet aksioni i madh për pastrimin e Kosovës, duhet të dalim të gjithë së bashku dhe t'u japim fund pamjeve të tilla me mbeturina. Kjo pason me një aksion tremujor deri në eliminimin e të gjitha mbeturinave", është shprehur ai. Hasanaj bëri thirrje që të

rishikohen strategjitë mjedisore për të parë pse ato nuk po funksionojnë dhe t'i ridraftojnë ato nëse është e nevojshme.

Ndërsa zyrtari tjetër i "Let's Do It Kosova", Besnik Shabiu, ka pohuar se këto aksione nuk arrijnë t'i largojnë të gjitha mbetjet në Kosovë. Ai u bëri thirrje të gjithë qytetarëve, madje edhe atyre që kritikojnë, që të bashkohen në këto aksione, sepse është koha e fundit që vendit t'i kthehet pamja që e meriton.

Përveç dhjetëra vullnetarëve të "Let's Do It Kosova", aksionit iu bashkua edhe Kompania "Natyra", e cila, përveç makinerisë për largimin e mbeturinave, ofroi edhe vullnetarë që iu bashkuan aksionit për pastrimin e brigjeve përgjatë rrugës tek pika kufitare në Merdare.

"Let's Do It Kosova" ka falënderuar edhe Kompaninë e Autobusëve "Dita" e cila ka ofruar ndihmë për transportin e vullnetarëve. Pika kufitare në Merdare ishte pastruar nga vullnetarët e "Let's Do It Kosovës" vetëm disa muaj më parë, në kuadër të aktiviteteve që ishin mbajtur për nder të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Aksioni i së dielës i ka paraprirë fushatës së madhe që është nisur për pastrimin e Kosovës nga mbeturinat. Më 15 shtator në Kosovë do të shënohet Dita e Pastrimit të Botës, e cila organizohet nga 200 vende të tjera.



## Sot fillon viti i ri shkollor

Me rastin e vitit të ri shkollor 2018/2019 në Kosovë, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka kërkuar nga nxënësit të angazhohen për nxënien e dijes në këtë vit shkollor, kurse për mësuesit ka kërkuar angazhim maksimal në punë

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

**PRISHTINË, 2 SHTATOR** - Sot (e hënë) fillon viti i ri shkollor 2018/2019 në Kosovë, me përjashtim të ndonjë shkolle e cila është duke u rinovuar. Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, ka uruar nxënësit dhe mësuesit. Ai ka thënë se 3 shtatori është ditë e madhe për vendin tonë. "Fillimisht u uroj nxënësve suksese në fillimin e mbarë të këtij viti për nxënien e dijes dhe shkathhtësive për jetën tuaj dhe të ardhmen tuaj. Data 3 shtator do të jetë një ditë e madhe, një festë e gjithë neve, sepse do të fillojë një angazhim i përbashkët për të ardhmen tonë. Veçanërisht u dëshiroj

mirëseardhje nxënësve që vijnë për herë të parë në bankat shkollore, të klasës së parë, duke iu dëshiruar suksese në vatrën e dijes. Të dashur mësues, ju uroj suksese në angazhimin tuaj dhe kërkoj nga ju ta bëni maksimumin në punën tuaj që nxënësit tanë të fitojnë dije dhe shkathtësi. Ju keni një profesion të shenjtë dhe si të tillë ju duhet deri në fund ta bëni maksimumin që nxënësit tanë të jenë ata që të gjithë po presim, që të jenë të rinjtë tanë të Evropës", ka thënë ministri Bytyqi në urimin e tij për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka bërë me dije se viti i ri shkollor do të nisë



pa greva. "Po, ky vit shkollor do të nisë më 3 shtator, pra nuk do të nisë me greva. Nuk kemi shkuar që në fillim me greva ngaqë duam të shohim se sa e si janë sistemuar kolegët tanë, pra duhet të shohim se si qëndron puna me kolegët tanë sa iu takon normave dhe se a ka

probleme me normat dhe me plotësimin e tyre. Po ashtu, nuk duam ta nisim vitin shkollor me greva sepse do të na kritikojnë disa se po bëjmë greva për ta vazhduar pushimin. Aq më shumë nga kjo nuk duam t'ua mohojmë gëzimin nxënësve, të cilët të gëzuar presin fillimin e

vitet të ri shkollor për t'u takuar me shokë e shoqe dhe me mësuesit e mësuesit të tyre pas pushimit veror. Mirëpo kjo nuk do të thotë se në vazhdim të vitit shkollor do të jetë çdo gjë e qetë, por mund të ketë edhe greva", ka thënë Jasharaj.

Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje (LV) ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Kurti paralajmëron protesta

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se shteti i Kosovës është duke kaluar çaste të vështira. Në këtë kontekst ai ka kërkuar mobilizim qytetar për protestat që do të mbahen në ditët dhe javët në vijim për ta kundërshtuar idenë e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas Kurtit, ideja dhe diskutimi për shkëmbim territorial që po quhet korrigjim kufiri sjell ndarjen e Kosovës dhe ndarjen e Kosovës Lindore

**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të dielën ka kërkuar mobilizim nga anëtarësia për pjesëmarrje në protestat që do të mbahen në ditët dhe javët në vijim për ta kundërshtuar idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, ai ka thënë se Kosova është duke kaluar çaste të vështira. "Një udhëheqësi e kapur dhe e kriminalizuar, në majë të së cilës qëndron presidenti Thaçi, po e nxjerr në shitje territorin e Kosovës për të fituar

paprekshmëri vetjake. Këtë nuk do ta lejojmë. Ata po e sjellin punën që shqiptarët prapë të largohen nga trojet tona kombëtare, ku jemi autoktonë. Por këtë gjë, e kemi detyrë historike e kombëtare, qytetare dhe njerëzore, që ta ndalojmë, që ta parandalojmë. Situata politike është aso që ka nevojë për pjekuri dhe forcim të organizatës dhe disiplinim të aktivistëve, sepse në ditët dhe javët e ardhshme do të vendosemi në krye të një procesi protestash qytetare e paqësore, për ta ndaluar këtë krim që po bëhet ndaj Kosovës dhe popullit tonë", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se protestat kanë për qëllim ndaljen e shitjes së Kosovës.

"Duhet të angazhohemi në protesta për ta larguar Thaçin, për ta ndaluar shitjen e Kosovës që po bëhet për imunitet politikësh nga gjykatat ndërkombëtare të imponuara prej vetë atyre. Jo të na i ndryshojë kufijtë një kriminel i cili është i shquar për dallavere me Serbinë dhe që na ka larguar edhe më shumë prej Shqipërisë gjatë qeverisjes së vet. Duhet të angazhohemi për largimin e Thaçit sepse Thaçi sot është më i dobët se kurrë, prandaj po bën edhe marrëveshje më të këqija se kurrë ndonjëherë më parë. Jemi edhe dëshmitarë që Prokuroria e Kosovës është bërë dhëmbë i kalbur i republikës sonë. E Qeveria është bërë Qeveri e brejtësve që e gërryejnë buxhetin e shtetit dhe pasuritë e Kosovës. Nuk mund ta durojmë një president qyq ndaj Serbisë dhe as një kryeministër zhvatës të buxhetit", është shprehur Kurti.

Ai ka vlerësuar se ndryshimi i kufijve e dëmton rëndë Luginën e Preshevës. Kurti ka thënë se, siç po flitet, për faktorë demografikë etnikë, pa përmendur të drejtat historike e pronësore, shqiptarët dalin të humbur. "Është bërë e qartë nga Serbia se ata nuk do të

lejojnë të preket territori matanë autostradës e hekurudhës, që ata e konsiderojnë të jetë strategjike, meqë e lidh Beogradin me Shkupin, Sofjen, Stambollin e Athinën. Kjo do të thotë se një numër i madh i fshatrave në komunat shqiptare, të cilat janë në të dyja anët e autostradës, nuk do të lejoheshin t'i bashkoheshin Kosovës që, sipas parimit demografik dhe duke mos lejuar afrimin tek autostrada e hekurudha, Serbia ka mundësi të lejojë vetëm qytetin e Preshevës, fshatin e Tërrnocit e Konçulit, që të bashkoheshin me Kosovën. Dikush mund të thotë se edhe kjo është fitore, sepse të paktën merr diçka, mirëpo kjo është humbje e madhe", ka thënë Kurti.

Ai ka vlerësuar se ideja dhe diskutimi për shkëmbim territorial (që po quhet korrigjim kufiri) sjell veçse ndarjen e Kosovës dhe ndarjen e Kosovës Lindore. "Ndarjen e Kosovës në lumin Ibër dhe ndarjen e Kosovës Lindore, përkatësisht veçimin e Preshevës nga Aksi A-10 dhe Bujanoci e Medvegja. Kjo logjikë është antishqiptare dhe ne do ta luftojmë atë", është shprehur ai. Kurti ka bërë me dije se Lugina e

Preshevës dhe shqiptarët atje kanë nevojë për respektimin e të drejtave njerëzore e politike, për ndihma institucionale dhe ekonomike nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe për reciprocitet, që ata të kenë po aq të drejta sa serbët në Kosovë. Sipas tij, nëse duhet të ketë bisedime me Serbinë, ato duhet të jenë parimore dhe t'i shërbejnë parimit dhe demokratizimit në të dyja vendet. "Ato duhet të bazohen tek njohja e Kosovës dhe pranimit, kërkimfalja dhe dëmshpërblimi për krimet e luftës, sepse bisedimi me Serbinë pa njohje të Kosovës e pa pranimit të krimeve të luftës, e forcon në Serbi faktorin kundër shqiptar. Ne e kemi në dorë ta mbrojmë jo vetëm vetveten nga Serbia, por edhe Evropën nga Serbia. Sepse ne e kemi në dorë që ta detyrojmë Serbinë ta ndryshojë veten para se të anëtarësohet në BE", ka theksuar Kurti. Ai ka thënë se ndryshimi në veri është në dëm të shqiptarëve sepse, sipas Kurtit, falja e territorit në veri është shkatërrim përfundimtar i shpresave për bashkim të Mitrovicës dhe për kthim të shqiptarëve në shtëpitë e tyre.



## Artistja Indira Çipa i bashkohet Vetëvendosjes

PRISHTINË, 2 SHTATOR (ER) - Pianistja Indira Çipa është anëtarësuar në Lëvizjen Vetëvendosje. Këtë e ka konfirmuar kryetari i kësaj lëvizjeje, Albin Kurti, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". "Me prof. Indira Çipa e cila na u

bashkua në Lëvizje erdhëm bashkë në 'EtnoFest' në Kukaj, i cili u hap mbrëmë me ekspozitat e veprave të dy artistëve tanë të mëdhenj, Simon Shirokës dhe Rexhep Ferrit. Znj. Indira Çipa vjen nga qyteti i Prizrenit, ku ka mbaruar shkollën fillore e të

mesme, për t'i vazhduar studimet universitare për muzikë në drejtimin e Pianos në Prishtinë, magjistraturën në Shkup, ndërkaq tash është në përfundim të doktoraturës në Tiranë mbi veprat pianistike të kompozitorit Zeqirja Ballata", ka shkruar Kurti.



# Konfiskohen mallra të falsifikuar

Në tregjet e Kosovës mund të blesh mallra tekstili, çanta dhe aksesorë të brendeve të njohura botërore si "Dolce & Gabbana", "Armani", "Louis Vuitton", "Gucci", "Chanel" dhe "Prada". Mirëpo çmimet e tyre radhiten në çmime të mallrave të cilësisë së ulët dhe sillen nga tre euro e tutje. Zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se, pas konfirmimit të originalitetit, janë konfiskuar mallrat në sasi prej 74 706 copë, ku vlera e tyre është 436 479.00 euro

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 2 SHTATOR** - Në tregjet e Kosovës mund të blesh mallra tekstili, si çanta dhe aksesorë të brendeve të njohura botërore "Dolce & Gabbana", "Armani", "Louis Vuitton", "Gucci", "Chanel" dhe "Prada". Mirëpo çmimet e tyre radhiten në çmime të mallrave të cilësisë së ulët dhe sillen nga tri euro e tutje. Sipas kategorisë së mallrave në përqindje më të lartë janë: tekstili 25 për qind, mbathje sportive 16 për qind, aksesorë dhe çanta për femra 26 për qind, preparate për përdorim personal (kozmetike dhe higjienike) 10.42 për qind, pajisjet elektronike/telefona dhe aksesorë 8 për qind dhe pije joalkoolike dhe alkoolike 7 për qind etj.

Lidhur me këtë, zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë se ky institucion sa i përket luftimit dhe parandalimit të ekonomisë joformale, në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, në vazhdimësi është përkushtuar të krijojë bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e biznesit. Sipas tij, kjo vërehet

përmes numrit të rritur të kërkesave për veprim të depozituar në Doganën e Kosovës dhe masave doganore ndaj mallrave që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Stavileci ka bërë me dije se për periudhën 1 janar deri më 31 korrik të këtij viti Dogana e Kosovës ka ndërmarrë veprime për mallrat që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale në 330 raste, në sasi prej 171 526 copë dhe vlerë prej 2 320 564.00 euro, prej të cilave, pas konfirmimit të originalitetit, janë konfiskuar mallrat në sasi prej 115 612 copë dhe vlerë prej 1 878 418.00 euro. "Nën dyshimin se shkelet e drejta e pronësisë intelektuale, Dogana e Kosovës ka ndërmarrë veprime ndaj mallrave ku, sipas kategorisë së mallrave, në përqindje më të lartë janë mallrat: aksesorë dhe kozmetikë 42 për qind, pije joalkoolike 14 për qind, preparate higjienike 7 për qind, veshmbathje 8 për qind, produkte ushqimi 6 për qind dhe të tjera 14 për qind etj", ka thënë Stavileci, duke shtuar se për periudhën 1. 1 deri më 31. 8. 2017, Dogana e Kosovës ka ndërmarrë veprime për mallrat



që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale në 161 raste për mallrat në sasi prej 156 049 copë dhe vlerë prej 956 175.00 eurosh, prej të cilave, pas konfirmimit të originalitetit, janë konfiskuar mallrat në sasi prej 74 706 copë dhe vlerë prej 436 479.00 eurosh. "Nën dyshimin se shkelet e drejta e pronësisë intelektuale, Dogana e Kosovës ka ndërmarrë veprime ndaj mallrave, ku sipas kategorisë së mallrave në përqindje më të lartë janë: tekstili 25 për qind, mbathje sportive 16 për qind, aksesorë dhe çanta për femra 26 për qind, preparate për përdorim personal (kozmetike dhe higjienike) 10.42 për qind,

pajisjet elektronike/telefona dhe aksesorë 8 për qind dhe pije joalkoolike dhe alkoolike 7 për qind etj", ka deklaruar Stavileci.

Kurse sa i përket natyrës së aplikimeve për patenta, sipas MTI-së, 70 për qind prej tyre i përkasin fushës së farmaceutike dhe të tjerat janë teknike. Sa i përket markave tregtare, sipas MTI-së, deri në korrik të vitit 2018 ishin 1 004 aplikime, ndërkaq në vitin 2017 ishin 1 575 aplikime. "Deri në korrik të këtij viti numri i aplikimeve për patenta ishte 12, kurse aplikimet në vitin 2017 ishin 33", është thënë në përgjigjen e zyrës për informim në MTI dhënë gazetës "Epoka e re".

Kurse sa i përket natyrës së aplikimeve për patenta, sipas MTI-së, 70 për qind të tyre nga këto vite raportuese janë të fushës farmaceutike dhe të tjerat janë teknike. "Për patentat nuk ka asnjë kundërshtim gjatë vitit 2017 dhe 2018. Për markat tregtare, Agjencia gjatë vitit 2017 ka pranuar 87 kundërshtime për markat e publikuara, ndërsa gjatë vitit 2018 ka pranuar 36 kundërshtime të markave tregtare. Agjencia për Pronësi Industriale ka mandat për zhvillimin e procedurave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale. Realizimi i të drejtave të dhëna nga vendimi për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale janë në



# a në vlerë prej 436 mijë eurosh



kompetencë të organeve zbatuese, si Policia, Dogana, Inspektorati, Gjykatat", është thënë në përgjigjen e MTI-së.

Ndërkaq drejtori i Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat të Tjera të Përafërta, Valon Kashtanjeva, ka thënë se nëse bazohemi në paditë në Gjykatën Themelore, mund të thuhet se ligji është duke u zbatuar, por nëse u referohemi informacioneve nga terreni, është e vërtetë se ka ende shkelje të drejtave të autorit. "Pronësia intelektuale, përkatësisht e drejta e autorit, gjithnjë e më tepër po tregohet si faktor ndikues në ekonominë e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj respektimi dhe zbatimi i drejtës së autorit është tejet me rëndësi. Përveç zhvillimit ekonomik, zbatimi i drejtës së autorit ndikon në stimulimin e krijimtarisë kulturore dhe kreative. Kur jemi te zbatimi i ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, në aspekt të zbatimit është më e vështirë të merren informacione sesa është niveli i zbatimit, ajo që mund të thuhet është se nëse marrim për bazë numrin e padive të cilat janë parashtruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, mund të themi se numri i shkeljeve është i vogël pasi ka shumë pak padi të ngritura", ka thënë Kashtanjeva për gazetën "Epoka e re".

Ai ka shtuar se nëse marrim për bazë informacionet nga terreni, ka ende shkelje të drejtave të autorit por, sipas tij, me rëndësi është se Inspektorati i Tregut ka vazhduar të marrë masa apo mbikëqyrje inspektuese, ashtu edhe Policia e Kosovës, aktivitete këto të cilat janë koordinuar në kuadër të Task Forcës kundër piraterisë. "Ka pasur në tre vjetët e fundit me mijëra kopje të materialeve pirate të sekuestruara dhe për subjektet të cilët janë gjetur duke shkelur të drejtën e autorit janë shqiptuar gjopa nga ana e inspektoratit të tregut", është shprehur Kashtanjeva.

## Pagë më të ulët se minimalja

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Paga minimale në Kosovë, e cila sillet nga 130 deri në 170 euro, ndonëse e ulët, në disa raste punëtorët në sektorin privat thuhet të marrin pagë edhe më të ulët se kjo. Nga hulumtimet që kanë bërë disa organizata ekonomike në Kosovë dhe nga ankesat që janë paraqitur në Sindikatën e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, është identifikuar se në tregun e punës punëdhënësit paguajnë punëtorë edhe me pagë më të ulët se ajo që është e përcaktuar si pagë minimale. Aktualisht, paga minimale në Kosovë është 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç, pagë kjo e cila nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 2011.

Avni Ajdini, kryetar i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (BSPK), ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se punëtorëve në Kosovë, në veçanti në sektorin privat, po u shkelen të drejtat e tyre nga punëdhënësit. "Në sektorin privat

punohet 12 orë dhe punëtori paguhet për 8 orë dhe për numrin e orëve që ai punon paguhet më pak se paga minimale. Paga minimale mund të jetë edhe më e ulët se 130 euro dhe kjo zakonisht ndodh në sektorin e pastrimit. Ankesa të punëtorëve ka, por ato më shumë janë në formë diskutimi, por jo në mënyrë të shkruar, pasi që me shkrim frikësohen t'i japin për shkak të problemeve që mund t'i kenë pastaj me punëdhënësin", ka thënë Ajdini. Ai ka thënë se paga minimale e cila është tani në Kosovë është e ulët dhe se kjo duhet të shënojë rritje. Pavarësisht prej trendeve ekonomike në të cilat ka kaluar Kosova gjatë këtyre viteve, paga minimale ka mbetur e pandryshuar që nga viti 2011. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të muajit korrik, është më i lartë për 1,2 për qind krahasuar me muajin korrik 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit.



## Balija: Kosova po shënon rënie të investimeve të huaja

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kosova është një vend me mjaft potencial, por as gjysma e këtij potenciali nuk po shfrytëzohet nga investitorët e huaj, ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Shpend Balija, drejtor ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë në Kosovë, duke shtuar se investimet e huaja direkte në vitet e fundit kanë shënuar rënie. Ai flet edhe për mangësitë ligjore të cilat po u shkaktojnë probleme disa kompanive në vend. "Nëse i shikojmë investimet e huaja direkte në Kosovë, shohim trend

të rënies dhe rreth 300 milionë euro ka qenë pika e investimeve të huaja direkte. Kjo nënkupton se nuk është një shumë e caktuar që jemi të kënaqur dhe sektorët nëpër të cilat janë këto investime, nuk janë sektorë që përfaqësojnë stabilitet ose qëndrueshmëri ekonomike për të ardhmen dhe si të tillë, kjo bazë prej 300 milionë eurosh duhet të rritet shumë më shumë ose të dyfishohet brenda viteve të ardhme. Ne kemi një rritje ekonomike prej katër përlindësh që është një performancë më e madhe se e shteteve të rajonit,



por për shkak të nivelit të lartë të papunësisë në Kosovë, kjo shkallë e rritjes nuk mjafton. Duhet bërë shumë më tepër sesa jemi duke bërë tash", ka thënë

Balija. Ai ka shtuar se Kosova është një vend që ka mjaft potencial për investime të huaja për biznes, por ai potencial nuk po zhvillohet dhe përdoret në

tërësi.

Në pyetjen nëse trajtohen të barabarta në treg të gjitha kompanitë vendore dhe ato ndërkombëtare, Balija ka theksuar se kompanitë vendore dhe të huaja trajtohen në mënyrë të barabartë. "Legjislacioni i trajton në mënyrë të barabartë dhe këtu nuk kemi asnjë problem dhe as pengesë. Në fakt, kemi partneritete shumë të mira me investitorët e huaj dhe partnerët lokalë të cilët krijojnë investim shumë të qëndrueshëm dhe krijojnë vende të punësimit", është shprehur Balija.

## Viti i ri shkollor nis me 10 ditë vonesë në dy shkolla në kryeqytet

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Dy shkolla fillore në kryeqytet, "Elena Gjika" dhe "Pavarësia", nuk do ta fillojnë vitin e ri shkollor këtë të hënë për shkak të renovimeve të papërfunduara. Lajmin e ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë", Jonuz Salihaj, drejtor i Arsimit në Komunën e Prishtinës, i cili ka pohuar se këto dy shkolla do ta fillojnë mësimin 10 ditë me vonesë. "Për 'Elena Gjika' kemi pasur disa probleme, është dashur të bëjmë investim 200 mijë euro

për shkak të renovimeve. 'Elena Gjika' është objekt i mbrojtur, na kanë penguar 10 ditë duke na vonuar lejen për renovim, prandaj është bërë vonesa. Sa i përket shkollës 'Pavarësia', kemi pasur kërkesa të shumta të nxënësve për shkak se është rritur numri i paraleleve të reja, është dashur të shtojmë edhe tri klasa dhe një kabinet", ka thënë Salihaj. Ai ka bërë me dije se ditët e humbura të mësimit do të zëvendësohen deri në fund të vitit shkollor.



## Ministri Gashi bën homazhe te varrezat e dëshmorëve në Landovicë

PRIZREN, 2 SHTATOR (ER) - Në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të Epopesë së Vrrinit në Prizren, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Landovicë. Me këtë rast, min-

istri Gashi ka thënë se nderimi për dëshmorët e lirisë është vlerë që na mban të fortë në rrugën e fuqizimit të shtetit. "Dëshmorët janë udhërrëfim për brezat e rinj dhe dëshmi se sa shumë gjak është derdhur për t'i jetësuar aspiratat

shumëshekullore të popullit tonë. Lavdi dëshmorëve!", është shprehur Gashi. Gjatë epopesë së lavdishme të Vrrinit nga 1 deri më 5 shtator 1998, në përballje guximtare ranë në altarin e lirie 28 pjesëtarë të UÇK-së.



## Edukatorja nga Skenderaj synon librin e rekordeve 'Guinness'

SKENDERAJ, 2 SHTATOR (ER) - Arbnora Fejza-Idrizi nga Skenderaj, me profesion edukatore, është kualifikuar për ta thyer rekordin aktual të librit të rekordeve "Guinness", me origami, që është art japonez, duke bërë palosjen e letrës, me përmasa prej 169 metrash katrorë. E tërë prova zyrtare e punimit të lules është

bërë në parketin e Palestrës Sportive të Qendrës së Kompetencës në Skenderaj, duke e palosur 23 herë letrën, e cila në fund të punimit jep pamjen e një luleje. Sipas procedurave zyrtare të autoriteteve të librit të rekordeve "Guinness", duhen prej 6 deri 8 javë për të kuptuar autorja e këtij punimi, Fejza-Idrizi,

nëse e ka thyer rekordin aktual që e mban një profesionist nga Franca, i cili e ka punuar veprën më të madhe me përmasa 10x10m. Në fund, Fejza-Idrizi ka falënderuar kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, për mbështetje të pazërvë në këtë përpjekje të saj për të hyrë në librin "Guinness".

## Inspektohen punimet në dy shkolla të Malishevës

MALISHEVË, 2 SHTATOR (ER) - Edhe në ditë pushimi nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka inspektuar dy shkolla, përkatësisht Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Bajram Curri" në Drenoc, në të cilën është duke u bërë rinovimi i objektit shkollor dhe punët nga punëkryesit janë në përfundim e sipër. Kjo vizitë me karakter inspektues ka qëllim që punimet të kryhen sipas standardeve dhe me cilësi të lartë. "Ne jemi të angazhuar maksimalisht për krijimin e kushteve të shkollave tona dhe për rregullimin e infrastrukturës shkollore jemi përgatitur

për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019. Ky vit do të jetë vit ku komuna do të investojë edhe në pajisjen e shkollave me laboratorë për lëndët e shkencave natyrore dhe në sferat e tjera shkollore", ka thënë ai. Po ashtu, Berisha ka inspektuar edhe punimet në Shkollën e Mesme të Ulët "Gjergj Kastrioti" në Llazicë, ku është ndërtuar objekti i ri shkollor, e që është në fazën finale apo përfundimtare të punimeve. Në një të ardhme të afërt nxënësit e kësaj shkolle dhe mësimdhënësit do ta fillojnë mësimin me kushte dhe standarde të larta.



# A mund të jetë ky plani i ardhshëm për Kosovën?

- Meditim vetjak për përlogaritjet që bëhen korridoreve dhe tryezave diplomatike lidhur me të ardhmen e Kosovës  
- Dekalogu i një zgjidhje të qëndrueshme apo molla e sherrit?



**Nga Bedri ISLAMI**

Prej disa javësh Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka hyrë, nëse mund të themi kështu, detit në këmbë, për të dhënë një zgjidhje të papritur, ndoshta edhe e dhimbshme, për të ardhmen e vendit të tij. Që të dyja anët e medaljes qëndrojnë mbi të dhe basti i vënë është nga më të rrezikshmit; jo vetëm për vetë atë, por edhe për rrjedhimet që mund të ketë një rajon shumë më i gjerë se Kosova.

Duke qenë i vetëdijshëm se është e pamundur të ketë ndarje të Kosovës - ai nuk e ka përfshirë këtë ide në projektin që ende askush nuk e ka të qartë deri në fund; duke e ditur mirëfilli se shkëmbimi i territorit është, po ashtu, një mision i porealizueshëm, ai gjeti një term politik, i cili nuk është përdorur deri tani - korrigjimi i padrejtësive, i cili mund të tingëllojë si qasje nacionaliste, por që i mbuluar në mjegullën e paqartësisë dhe i nisur nga e djeshmja e Thaçit si shefi i Qeverisë, periudhë në të cilën u bënë lëshime të mëdha ndaj agresivitetit politik serb, dyshimet janë më të ndjeshme.

Thaçi sa vjen e bëhet më i kuptueshëm, por enigma mbetet. Ditët e fundit ai deklaroi se nuk do të ketë as ndarje të Kosovës, as ndryshim të kufijve, por do të kërkojë më 7 shtator që Lugina e Preshevës, e njohur më shumë si Kosova Lindore t'i bashkohet mëmësisë së saj, Kosovës.

Shumë e lehtë për t'u shtruar, shumë e pëlqyeshme për të qenë e vërtetë, shumë e vështirë për t'u besuar dhe praktikisht e pamundur, nëse pas saj nuk ka lëshime të tjera të papërbalueshme për Kosovën dhe të dëshirueshme për shtetin serb.

Që nga qershori i vitit 1999, kur po tërhiqej nga Kosova, shteti serb dhe gjithë strukturat e tij, që nga Akademia Serbe dhe deri te Kisha ortodokse e saj, duke përfshirë mes tyre edhe shërbimin e fshehtë dhe bandat e politikës, kanë menduar vetëm një gjë: kthimin në Kosovë, ose, në pamundësi të saj, rrëmbimin e sa më shumë të drejtave për serbët në Kosovë. Përvoja e serbizimit të Bosnjës ka qenë një praktikë e provuar prej tyre dhe këtë e kanë synuar edhe në Kosovë.

Deri tani, mjerisht, shumë herë pala shqiptare është thyer nga vrulli i ofensivës politike serbe; ata janë gjendur më shumë përballë njëri-tjetrit sesa në krah të njëri-tjetrit, si po ndodh edhe këto ditë. Kaq shumë deklarata kontradiktore ka në politikën shqiptare të Kosovës sa është e vështirë të marrësh vesh se kush është dhe me kë, cilët janë atdhetarët e cilët përfituesit.

Paraja serbe e futur në Kosovë, përmes një ingranazhi të sofistikuar, por të njohur mirë, ka bërë punën e saj dhe njerëzit që mund të vendosin, janë tulatur. Shërbimi i fshehtë serb në Kosovë ka pasur dhe vazhdon të ketë njerëzit e tij në shumë struktura të larta të politikës dhe, për fat të keq, ata nuk do të mund të hiqen aq lehtësisht, në mos tjetër, vetë ndërtimi i tyre i favorizon ato.

Lëngimi i politikës shqiptare në Kosovë, kur ajo kishte mbështetjen më të fuqishme të perëndimit është e mundur të shpaguehet rëndë: njëri ndër boshtet ku është mbështetur kjo politikë ka filluar të lëkundet, ndryshimi i stafit drejtues në SHBA është pikëlueshëm i rëndë për deklaratimet, si ato të këshilltarit për Siguri Kombëtare pranë Presidentit amerikan, John Bolton.

Megjithatë, nga burime pranë qendrave studimore të lidhura me Kosovën dhe gjithë rajonin përreth saj, mendohet se janë hedhur pikat kryesore që mund t'i parashtrohen dy presidentëve në 7 shtator apo edhe disa ditë më pas, kur gjërat të jenë më të qeta dhe kur presioni do të jetë më i lehtë se tani.

Cilat mund të jenë ato:

1. Serbia të njohë shtetin e pavarur të Kosovës dhe të bëjë modifikimet e duhura në Kushtetutën e saj.

Shënim: Njohja e Kosovës si shtet i pavarur nga shteti serb do të thotë pranimit të faktit dhe de jure i një realiteti të ri politik dhe do të kishte ndikim të jashtëzakonshëm për njohjen e mëtejshme të shtetit të Kosovës. Enigma mbetet në atë që qëndron pas kësaj njohje, cilat janë nënurat e këtij vendimi dhe a përputhen ato me aspiratat e popullit në Kosovë?

2. Të bëhet korrigjimi i kufirit të tashëm ekzistues duke kaluar dy komuna me popullsi dërmuese serbe, Leposaviqi dhe Leshaku në shtetin serb, ndërsa komuna e Preshevës të jetë pjesë e Kosovës. Dy komunat tjera, Bujanovci dhe Medvegja, për shkak të përqindjes së madhe të banorëve serbë, nga dëbimi i shqiptarëve, të kenë të drejta më të ndjeshme autonome, por nuk do të jenë pjesë e

Kosovës.

Meditim: Kjo mund të sjellë një reaktion zinxhir të pandalshëm dot, jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe rreth tyre. Nga ana tjetër, braktisja e dy komunave shqiptare, nga të cilat banorët janë shpërngulur dhunshëm, do të mund të trajtohet si braktisje e bashkatdhetarëve dhe do të kemi pas pak vitesh dy komuna të tjera të zbrazura nga vendasit autoktonë.

Besohet se për miratimin e këtij ndryshimi, që nuk do të quhet shkëmbim terriroresh, Presidenti i Kosovës do i drejtohet popullit përmes një referendumit, në të cilin është i bindur se do të ketë përkrahje të ndjeshme.

3. Si shenjë e pranimit të republikës së Kosovës dhe vendosjes së marrëdhënieve me shtetin serb, në të dy anët, të bëhet një amnisti e përgjithshme për të gjithë krimet e luftës dhe, në këtë rast, të ndalojë aktivitetin e saj Gjykata Speciale. Shënim: një amnisti e tillë do e shfaqë shtetin serb nga gjithë krimet që ka bërë në Kosovë në mënyrë institucionale. Krimet e pashembullta në Kosovë, sidomos në periudhën e luftës çlirimtare, janë të përbindshme; ata kanë marrë jetë e mijëra njerëzve në emër të shtetit të tyre; ende mijëra njerëz kërkojnë të afërmit e tyre.

Nga ana tjetër, pranimiti i kësaj amnistie do të ishte dënim i rëndë për vetë luftën çlirimtare, pasi akuzat e hedhura nga Dik Marty dhe Karla Del Ponte, do të mbeteshin si fakte jetike dhe do e shoqëronin Kosovën në gjithë vazhdimin e mëtejshëm të jetës së saj.

Ideja e një amnistie të përgjithshme, e cila, si mendohet, vjen nga administrata amerikane, do lehtësonte trazimin e shumë liderëve të sotëm politikë, në të gjithë forcat politike, të cilët ndjekin me ankth zhvillimin e hetimeve.

Si duket, edhe deklarata e vonshme e prokurorit të përgjithshëm, se ende nuk ka gjetur fakte që mund të ngrihen akuzat të plota, është rrjedhë e këtij mendimi.

4. Shtetet perëndimore që deri tani kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë presion ndaj shtetit serb, duke e kushtëzuar pozitën e saj ndërkombëtare me njohjen e shtetit të Kosovës, do të ndikojnë për pranimin e shpejtë dhe pa kushte të tjera të shtetit serb në strukturat e larta të BE.

Shënim: në fakt, ky është njëri ndër synimet më të rëndësishme të shtetit serb. Pranimiti i saj në BE do të kishte zhvillime negative edhe për vetë Kosovën, e cila nesër mund të ndeshet me refuzimin e saj për të përfituar në minoritetin serb që ka në Kosovë, por do të bënte të mundur që edhe shteti shqiptar të kishte refuzimin serb për pranimin e tij në BE.

5. Kosova, pas njohjes së shtetit të saj nga Serbia do të marrë disa avancime ndërkombëtare, të mirëpritura dhe të domosdoshme për vetë statusin e saj, si pranimiti në OKB fillimisht, e më pas në NATO, BE dhe struktura të tjera jetike.

Në fakt, megjithëse e mirëpritur, ky do të ishte bonusi që do i jepej Parlamentit të Kosovës, i cili, i ndodhur përballë kësaj dileme: ose pranimiti në OKB e më pas në NATO e BE, duke pranuar këtë marrëveshje, ose qëndrimi larg tyre, do të mund të zgjidhnin mbështetjen e këtij pakti, edhe pse shumë prej tyre nuk do të ishin dakord. Partitë në pushtet, sipas përvojës së deritashme, me ndonjë përjashtim të pakët, do të ishin pro, edhe LDK-ja do të shkonte në këtë rrugë, problemi do të mbetej Lëvizja VV, e cila, duke e ditur se kohët e vështira janë në prag, duan të shpejtojnë me zgjedhjet e reja politike, për ndryshimin e qeverisë.

6. Formimi i Zajednicës, bashkësisë së komunave me shumicë serbe, nën një asociacion të vetëm, të përbashkët, i cili do të jetë fillimisht sipas planit të paraqitur nga Marti Ahtisaari dhe i miratuar nga parlamenti i Kosovës. 10 komuna me shumicë serbe, disa nga të cilat në verium e Kosovës, do të kenë të drejta më të shumta autonome, por pa e shkëputur nga ligjet dhe vendimet e Parlamentit të Kosovës.

Shënim: Megjithëse nuk do të mund të jetë e shkruar fare qartë, krijimi i këtij Asociacioni do të kalojë përmes disa fazave; ai do të ketë rritje dhe ndjeshmëri më të lartë gjithëherë kur Kosovës do i afrohen përparësi politike e diplomatike, si në rastin e pranimit në OKB dhe kështu që, jo papritmas, ky Asociacion do të mund të ketë të gjitha atributet e një republike të re serbe brenda trupit të Kosovës, por shumë më e rrezikshme dhe më agresive se ajo e Bosnjës, pasi nuk është në një territor kompakt dhe ka me vete mbështetje të fuqishme nga shteti serb, si karamelja për njohjen e shtetit të Kosovës.

Zonat me rëndësi jetike për Kosovën, si Mitrovica apo qendrat e tjera jetike, nuk do të ndahen. Ata, edhe më tej do të administrohen si tani.

Shënim: Në fakt, si thotë profesor Rexhep Qosja, komuna e Mitrovicës së Veriut, është që tani si një komunë autonome e përtej saj. Serbët nuk do të synojnë ta bëjnë edhe publikisht të njohur një fakt, i cili, megjithatë, njihet. Politika e 20 viteve në Kosovë çështjen e bashkimit të Mitrovicës e ka pasur slogan politik, një çështje sa për të shkuar kohën, asnjëherë dhe nga askush nuk është bërë diçka e vyer për të bërë bashkimin e një komune, e cila ka qenë gjithnjë bashkë.

Me krijimin e Asociacionit serb në

Kosovë, kjo komunë, e Mitrovicës së Veriut, edhe më tej do të jetë e shkëputur faktikisht nga Kosova dhe e afruar me Beogradin.

Do të duhej domosdoshmërisht që në diskutimin e saj, dhe jo vetëm të saj, të vendosen pikat mbi "i", për heqjen dorë të shtetit serb dhe strukturave të saj të ndërhyrjes në punët e Kosovës dhe të mbështetjes politike dhe informative të këtyre komunave.

8. Të bëhet definimi përfundim i kufijve, demarkacioni, sipas ndarjes administrative të shtetit jugosllav, duke pasur parasysh edhe pikat e cekura në marrëveshjen e mësipërme. Lëvizjet e natyrshe do të monitorohen nga ekip ndërkombëtar dhe miratohen nga parlamentet përkatëse.

Shënim: Përvoja e demarkacionit me shtetin malazez dëshmoi se lehtësisht mund të falen pjesë të territorit shqiptar në veriun e tij, ashtu si ndodh edhe në jugun e Kosovës, në ndërlidhjen me shtetin maqedonas.

Sa herë që Kosova ka synuar të definojë kufijtë, aq herë ka humbur.

9. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe struktura të fuqishme të institucioneve evropiane të propozojnë pranë Komisionit të Posaçëm për Çmimin Nobel për Paqe që të nominojnë presidentët Thaçi e Vuçiq për arritjen e marrëveshjes. Shënim: Kjo, në fakt, do të ishte karamelja e fundit e një marrëveshje politike, e cila, kështu si është hedhur, shumë vështirë do i dukej si e pranueshme, por që, duke qenë baza e një diskutimi të gjatë dhe të vështirë, do të kishte pas vetes edhe pasoja të paparashikuara.

10. Mes Republikës së Kosovës dhe republikës së Serbisë, përmes strukturave dypalëshe dhe me praninë e institucioneve ndërkombëtare, të zgjidhen me marrëveshje dypalëshe të gjitha problemet e mbetura nga e kaluara, sidomos në fushën e energjisë, të sigurimit pensional, të lëvizjes së lirë, të tregtisë etj.

Në vend të mbylljes:

Dekalogu i menduar më sipër, i cili po diskutohet në shumë qarqe jashtë Kosovës, mund të mos i jetë i gjithi i shtruar më 7 shtator, por sinjalet janë dhënë se përmes tyre do të kalojnë shumë përplasje të fuqishme dhe, po ashtu, shumë lëshime të pasojshme.

Ndoshta vetëm ndonjëra prej tyre mund të realizohet.

Por diskutimi i shtatorit duhet të fillojë jo nga miqësia presidenciale, por nga njohja e menjëhershme e republikës së Kosovës, që gjërat të jenë të barabarta dhe të kalojnë atë cakun e padëshirueshëm të nëpërkëmbjes.

Në fund të fundit, ajo nga e cila trembem personalisht qëndron në thënie e vjetër se "asnjëherë krushqitë me serbët, aq më tepër, krushqitë politike, nuk kanë qenë në të mbarë të Kosovës".

## Papa Françesku bën thirrje për mbrojtje të civilëve në Siri

VATIKAN, 2 SHTATOR - Papa Françesku, në fjalimin e tij të përjavshëm bëri thirrje ndaj të gjitha palëve të përfshira dhe që kanë ndikim në Siri, të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe ta ruajnë popullatën civilë në rajonin e Idlib, që po përballlet me sulme nga forcat qeveritare. Pas shtatë vjetësh luftë civile, provinca siriane Idlib dhe rajonet përreth janë ndër enklavat më të mëdha të kontrolluara nga rebelët kundër

presidentit sirian Bashar al-Assad, një aleat i afërt me Rusinë. Një burim tha për "Reuters" se Assad po përgatit një sulm ofensiv për ta rikthyer provincën. "Erërat e luftës po fryjnë dhe ne po marrim lajme të këqija për rrezikun e mundshëm të katastrofës humanitare në Siri, në provincën Idlib", tha Papa Françesku para mijëra personave të mbledhur në sheshin Shën Pjetri. "Unë kërkoj nga komu-

niteti ndërkombëtar dhe të gjithë personat e përfshirë që t'i përdorin mekanizmat e diplomacisë, dialogut dhe negociatave për ta siguruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e jetëve të civilëve", tha ai. Një ofensivë e madhe në Idlib, ku të zhvendosurit kanë arritur numrin e gjysmës së popullsisë, rrezikon zhvendosjen e 700 000 sirianëve të tjerë nga shtëpitë e tyre, raportojnë Kombet e Bashkuara.



## Gjenerali Miller, komandant i NATO-s në Afganistan

John Nicholson, komandanti i 17-të i NATO-s në Afganistan dhe i forcave amerikane atje, u largua të dielën nga ky post, me një ceremoni për ndryshimin e komandës në Kabul. Në vend të tij vjen gjenerali amerikan Austin Scott Miller, në një kohë kur Afganistani po përjeton një kombinim të shpresës, shqetësimeve dhe pasigurisë për të ardhmen

KABUL, 2 SHTATOR - John Nicholson, komandanti i 17-të i NATO-s në Afganistan dhe i forcave amerikane atje, u largua të dielën nga ky post, me një ceremoni për ndryshimin e komandës në Kabul. Në vend të tij vjen gjenerali amerikan Austin Scott Miller, në një kohë kur Afganistani po përjeton një kombinim të shpresës, shqetësimeve dhe pasigurisë për të ardhmen. Gjenerali Nicholson është komandanti më afatgjatë i NATO-s në Afganistan. Ai shërbeu për gati gjashtë vjet në Afganistan, që pas 11 shtatorit. Ekspertët thonë se vetëm koha do të tregojë nëse trashëgimia e tij do të krijojë premisat për suksesin e Qeverisë afgane, apo nëse thjesht ruajti status quo-në me talebanët.

Lufta në Afganistan vazhdon të jetë intensive, me humbje të mëdha ndër talebanët dhe, po ashtu, ndër forcat afgane të sigurisë. Ndërsa gjenerali amerikan John Nicholson dorëzon komandën e forcave amerikane dhe ndërkombëtare, ekspertët thonë se nuk kanë parë progres për asnjërin nga palët. "Mendoj se fjala ngërç do të ishte përshkrimi më i mirë për dinamikën e dy vjetëve të fundit në Afganistan", thotë Michael O'Hanlon, i Institutit Brookings. Nicholson luftoi përkrah

afganëve përpara se të caktohej komandant. Sapo u emërua në krye të luftës, ai kërkoj ta përmirësojë jetën e ushtarëve të thjeshtë afganë.

Gjatë seancës dëgjimore për konfirmimin e tij në janar 2016, ai tha se do të përpiqej t'i jepte fund korrupsionit në Afganistan, në veçanti për rrogat e ushtarëve. "Në vend të pagesave me para të gatshme, që krijojnë hapësirat për përvetësim, do t'i paguajmë ushtarët nëpërmjet një sistemi automatik, ku çdo individ merr shumën e plotë", shprehej gjenerali Nicholson. Ushtria amerikane thotë se kurseu rreth 62 milionë dollarë vitin kaluar që do të kishin shkuar për ushtarë dhe policë fantazma. Megjithatë, kjo shifër nuk është konfirmuar dot nga monitorues të pavarur.

Pas zgjedhjes së presidentit të ri, Nicholson kërkoj një strategji të re dhe shtimin e disa mijëra ushtarëve të forcave ndërkombëtare. Ai tha se shtimi i njëjësive do të ndihmonte për t'i hedhur në ofensivë forcat afgane, përmes rritjes së fuqisë luftarake ajrore dhe dyfishimit të numrit të forcave speciale afgane brenda një periudhe katërvjeçare. "Kapacitetet ofensive do të thyjnë ngërçin në Afganistan. Ndër forcat afgane të sigurisë, kryesoret



për këtë janë forcat e tyre speciale dhe forcat ajrore", deklaroi gjenerali Nicholson.

Por, kjo është një strategji që kërkon më shumë kohë, të cilën shumë amerikanë të lodhur nga lufta dhe tashmë me një president të paduruar, ndoshta nuk e dëshirojnë më. Por, ky është një plan që zyrtarët në Pentagon thonë se është i domosdoshëm për t'i ulur talebanët në negociata. "Do të vazhdojmë të punojmë për këtë. Mendojmë se duhet t'i përmbahemi kësaj strategjie dhe objektivit tonë për të arritur një zgjidhje të negociuar", thotë Sekretari i Mbrojtjes, Jim Mattis. Zyrtarët përmendin armëpushimin e këtij viti si dhe shpresat për një armëpushim tjetër në javët e ardhshme si shenja progresi. Ata thonë se sulmet e përgjakshme rishtazi në qytetin Ghazni dëshmojnë se talebanët vrasin pa dallim dhe se nuk i ruajnë dot më territoret që përpiqen t'i marrin Qeverisë afgane.

## Pentagoni po ndalon ndihmën ushtarake për Pakistanin

WASHINGTON, 2 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara po e anulojnë ndihmën ushtarake prej 300 milionë dollarësh për Pakistanin, ngaqë ky vend i Azisë Jugore mendohet se ka dështuar në marrjen e "masave vendimtare" kundër militantëve. Shtetet e Bashkuara i kanë bërë thirrje Pakistanit të mos strehojë militantët që kryejnë sulme në Afganistan. Zyrtarët amerikanë e akuzojnë Islamabadin se nuk ka marrë masa kundër kryengritësve, por Pakistani thotë se ka shpenzuar miliarda dollarë dhe se ka humbur shumë jetë njerëzish në luftën kundër terrorizmit.



Disa muaj më parë presidenti Donald Trump tha se në këmbim të miliarda dollarëve të ndihmës amerikane, Pakistani nuk ka bërë asgjë për ShBA-në, veçse mashtrime. Zëdhënësi i Pentagonit tha se institucioni i tij do t'i shpenzojë paratë për përparësi të tjera më urgjente. Ky vendim i Pentagonit duhet të miratohet nga Kongresi i ShBA-së.

## May: Nuk ka kompromis me Bashkimin Evropian për Brexit

LONDËR, 2 SHTATOR - Kryeministrja britanike Theresa May ka insistuar se ajo nuk do ta ndryshojë planin e Brexitit gjatë negociatave me Bashkimin Evropian. May tha se ajo nuk do të bëjë asnjë kompromis që nuk është në interes kombëtar, por theksoi se nuk do të jetë dakord me

thirrjen për referendumin e dytë për marrëveshjen. Sipas saj, kjo do të ishte një tradhti e madhe ndaj demokracisë dhe besimit. Marrëveshja e arritur me Bashkimin Evropian do ta mundësonte tregtinë mes dy palëve. Por, kritikët thonë se kjo marrëveshje do ta mbajë

Mbretërinë e Bashkuar të lidhur me BE-në. Vota popullore, parti që përbëhet nga disa deputetë të zgjedhur, ka thirrur për referendum ndaj marrëveshjes finale të Brexitit. Mbretëria e Bashkuar pritet të dalë përfundimisht nga Bashkimi Evropian më 29 mars.



Fjalë e mbajtur në konferencën shkencore "40 vjet veprimtari shkencore e krijuese të prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha"

# Kontributi atdhetar i gruas shqiptare parë nën prizmin e studimeve të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha



**Prof. dr. Teuta SHALA - PELI**

Duke iu referuar krijimtarisë shkencore të prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha, është e njohur se shkrimet e studiueses në fjalë shquhen për vlerën dhe rëndësinë që kanë për trajtimin dhe ndriçimin e problemeve të shumta nga historia jonë bashkëkohore. Në këtë aspekt, duke treguar interesim dhe pasion të veçantë për ndriçimin e problemeve të shumta që e karakterizojnë periudhën në fjalë, studiuesja i kushtoi kujdes të veçantë edhe kontributit të gruas në çështjen kombëtare shqiptare, duke botuar monografi, punime shkencore, si dhe fejtone kushtuar kësaj çështjeje. Me sa duket nga shkrimet e saj, interesimin për ta vënë në pah rolin atdhetar të gruas shqiptare e shfaq pothuajse në fillim të karrierës së saj. Falë angazhimit dhe punës së palodhshme, në opusin shkencor të profesoreshës, vetëm për kontributin e gruas ne sot kemi një monografi shkencore: "Kontributi atdhetar i Hyrije Hanës", Libri Shkollor, Prishtinë, 2011 dhe 54 punime shkencore të botuara në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit që disa do t'i përmendja, si: "Roli i gruas në lëvizjen kombëtare shqiptare", "Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarë", Prishtinë, 1995; "Portreti i nënës së Isa Boletinit", "Isa Boletini dhe koha e tij", Prishtinë, 1998; "Fëmijëria dhe rinia e Shotë Galicës", "Shotë Galica, heroinë e kombit", Prishtinë, 2003; "Prezantimi i gruas shqiptare në periudha të ndryshme kohore", Kosova, nr. 24/25, 2002/2003, 2003; "Trajtimi i çështjes së gruas shqiptare në revistën ilegale "Kosovarja e re" (1983-1984)", organ informativ i BGK të LRSShJ-së; "Gjurmime albanologjike", seria e shkencave historike, nr. 38-2008, f. 9-30, Prishtinë 2009; "Gratë shqiptare për çështjen kombëtare", revista shkencore "Kosova", nr. 35/36, 2012; "Disidentja e parë shqiptare - Musine Kokalari", "Epoka e re", 10 shkurt 2007; "Anëtarja e devotshme e NDSH-së", "Koha

ditore", 17 shkurt 2007; "Përpjekjet për balancë gjinore në dokumentet ndërkombëtare gjatë historisë", "Epoka e re", 24 shkurt 2007; "Gratë në Parlamentin shqiptar gjatë historisë", "Paqja", Viti III, nr. 17, 19 prill 2008, Prishtinë; "Angazhimi i grave në jetën politike e vendimmarrëse në Kosovë", "Epoka e re", 10 maj 2008, Prishtinë; "Edhe gratë shqiptare në burgjet jugosllave", "Epoka e re", 18 tetor 2008; "Nënëlokja e madhe që rriti trimat e kombit", "Epoka e re", 17 janar 2009; "Disidentja e parë shqiptare - Musine Kokalari", "Shqiptari, Rumani", 1 janar 2010; "Disidentja e parë shqiptare - Musine Kokalari", "Dielli", Nju Jork, numri festiv i vitit të Ri 2010; "Parashqevi Qiriazi, diplomatja e vetme grua në Konferencën e Paqes në Paris (1919)", "Kosova sot", 3 dhjetor 2011; "Xhevë Krasniqi-Lladrovci, flakadan i pashuar lirie", "Kosova sot", 16 qershor 2012; "Ismail Qemali, pavarësia e Shqipërisë dhe gruaja shqiptare", "Epoka e re", 7.3.2012; "Qëndresa e grave të familjes Jashari", "Epoka e re", 8-9 mars 2018 e shumë e shumë studime të tjera që temë trajtimi kishin gruan dhe aktivitetin e saj

atdhetar. Jo vetëm kaq për kontributin e gruas. Kemi edhe fejtone të shumta të botuara në shtypin ditor, ku trajtohet kontributi atdhetar i gruas shqiptare në përgjithësi, që nga pavarësia e Shqipërisë e deri në ditët e sotme. Ku trajtohen probleme të shumta lidhur me rolin dhe angazhimin e gruas në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në Lëvizjen Ilegale, si dhe në politikë, duke bërë një vështrim për angazhimin e gruas shqiptare në parlamentin shqiptar që nga fillimi e deri në ditët e sotme, si dhe për fatin tragjik të shumë femrave me të cilat ato përballen në burgjet jugosllave. Duke hulumtuar në bibliografinë shkencore të profesoreshës kemi hasur në shkrimet që u kushtohen drejtpërdrejt figurave të grave si: Shotë Galica, Musine Kokalari, Marie Shllaku, Parashqevi Qiriazi, Hyrije Hana, Xhevë Krasniqi-Lladrovci, duke na sjellë të dhëna dhe fakte me interes jo vetëm për jetën dhe veprimtarinë e tyre, por edhe për kohën në të cilën jetuan dhe vepruan ato në përgjithësi. Me shkrimet e veta profesoresha në të njëjtën kohë nuk la anash as kontributin e nënave, grave dhe vajzave të atdhetarëve për veprimtarinë e të cilëve ka shkru-

ar për gjatë 40 vjetëve të veprimtarisë shkencore. Duke iu referuar këtij fakti, profesoresha me shkrime i kushton vëmendje të veçantë nënës së atdhetarit Isa Boletinit, pastaj nënës së Jusuf e Bardhosh Gërvallës, gruas së Mulla Idriz Gjilanit, si dhe shumë e shumë figurave të tjera, duke shkruar së fundi edhe për kontributin dhe sakrificën e grave dhe vajzave të familjes Jashari për nder të 20-vjetorit të rënies së tyre. Në vazhden e të dhënave për kontributin e gruas, profesoreshës i takon merita edhe për shkrimet ku trajtohet kontributi i gruas në fushën e arsimit, duke veçuar shkrimet që i kushtohen shkollës së parë shqipe për vasha në Prizren. Krahas të dhënave të përmendura më lart, për njohjen e kontributit të gruas me mjaft interes është edhe monografia kushtuar Hyrije Hanës, në të cilën është përfshirë kontributi atdhetar i Hyrije Hanës që nga fillimi i veprimtarisë e deri në fundin e jetës së saj (2 korrik 2004), duke trajtuar çaste të rëndësishme nga veprimtaria atdhetare e Hyrije Hanës siç janë: tri burgosjet e saj, jeta ilegale, si dhe jeta e Hyrije Hanës

pas vitit 1981. Në fund të librit përfshihen edhe kujtimet e disa personaliteteve që e kishin njohur Hyrije Hanën për së afërmi. Shikuar realisht, nga sa u tha më lart, rezulton se studimet e prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha na ofrojnë mundësi t'i perceptojmë në përgjithësi të dhënat me rëndësi që ndërliqen me kontributin e gruas shqiptare të cilat u trajtuan më lart.

Si rezultat i tërë kësaj del qartë se veprat e studiueses në fjalë përbëjnë një kontribut të veçantë për njohjen, hulumtimin dhe studimin e problemeve të shumta nga periudha bashkëkohore ngaqë janë të mbështetura në burime arkivore.

Dhe krejt në fund, nga analiza e veprave të prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha mund të konkludojmë se gjatë veprimtarisë së saj shkencore 40-vjeçare, falë punës dhe pasionit për shkencën, ne sot kemi disa vëllime të monografive të cilat na ofrojnë ndihmesë të madhe në studimin dhe trajtimin e problemeve të shumta nga periudha bashkëkohore, duke na u ofruar një mundësi e mirë për t'u thelluar në trajtimin e problemeve specifike nga periudha në fjalë.



**E rrallë**

## Gruaja që ha dyner tre kilogramësh

Një blogere ushqimesh gati sa nuk vdiq kur pranoi sfidën e fundit të ngrënies së ushqimit, të hajë një dyner në madhësinë e një jastëku. Ylli i medieve

sociale, 24 vjeçarja Katie Ovens, u bë e famshme për apetitin e saj të jashtëzakonshëm e që së fundmi hëngri një dyner që peshonte tre kilogramë dhe



që përmbante rreth 8 000 kalori.

## BARSOLETA E DITËS



**Klienti në restorant:**

- Klienti: Më fal, qysh është pasvordi i wiffis?

- Kamerieri: Prej Nishit deri në Zagreb.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

### “INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



## FOTO E DITES



Peshkatarët një anije peshkimi në Detin Mesdhe në perëndim të diellit në Liban. /Photo:AP/

Në ora 18:20

### “FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

### “ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed



Në ora 22:00

### “LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

## E jashtëzakonshme

# 95-vjeçari thyen rekordin personal si zhytësi më i vjetër

Një veteran 95-vjeçar britanik i Luftës së Dytë Botërore ka thyer rekordin e vet personal të shtunën, si zhytësi më i vjetër në botë, pasi u zhyt në thellësi për ta eksploruar një anije të fundosur jashtë Qipros. Ray Woolley, i cili mbushi 95 vjet më 28 gusht, tashmë mban



rekordin si zhytësi më i vjetër aktiv. Ai hyri për 44 minuta në thellësi prej 40.6 metrash, duke kaluar rekordin e vet të mëparshëm prej 41 minutash dhe 38.1 metrash, derisa ishte 94-vjeçar.



### DASHI

Me shumë mençuri arrini të menaxhoni çfarëdo lloj situatë që do t'ju ofrojë dita.



### DEMI

Edhe pse sot personat afër jush ju ndiejnë larg dhe jo përfshirës në biseda, kjo është një strategji e mirë për të mos dalë kundër tyre.



### BINJAKËT

Projekte të reja dhe ecje në karrierën tuaj profesionale po paraqiten në horizont. Do t'i kapni në ajër dhe do të përfitoni nga kjo gjë.



### GAFORRJA

Në çështje pune dhe ato familjare jeni autoritare dhe jepni gjithmonë zgjidhjen përfundimtare. Njerëzit që keni pranë besojnë tek ju.



### LUANI

Sot do të përfundoni gjithçka që keni lënë pezull nga java e kaluar. Shpirti juaj i iniciativës sot do të jetë vendimtar në zgjidhjen e problemeve.



### VIRGJËRESHA

Nuk është e nevojshme të jepni mend edhe për ato çështje që nuk i njihni mirë. Ndonjëherë të dëgjosh zgjidh më shumë punë se të flasësh.



### PESHORJA

Do të jeni rebel dhe nervoz sot dhe pa ndonjë shkak ose arsye. Kjo gjë do t'ju bëjë të jepni vendime të dyshimta lidhur me disa çështje.



### AKREPI

Ndjenjat dhe emocionet sot do të jenë primare në ditën tuaj. Çdo gjë duket se shkon ashtu siç duhet dhe do të udhëhiqeni nga zemra.



### SHIGJETARI

Mos lejoni që stresi ta shkatërrojë ditën e sotme. Edhe pse do të keni disa vonesa në çështje të caktuara, nuk është fundi i botës.



### BRICJAPI

Keni plane afatgjata lidhur me një person të caktuar, por do të ishte mirë që edhe ai të ishte në dijeni të ndjenjave tuaja për të.



### UJORI


Problemet që mund t'ju dalin sot në punë mund t'i zgjidhni vetëm duke ruajtur qetësinë dhe pa ju kapur paniku.



### PESHQIT

Gjithë dita juaj sot do të kalojë në një përshtjellim ndjenjash dhe arsyesh. Nuk po dini të ndani disa gjëra që ju shqetësojnë.

## Aktorja e famshme bëhet nënë në moshën 48-vjeçare



**Ç**ifti janë të njohur për faktin se e mbajnë jetën e tyre private larg syrit të mediave. Daniel Craig dhe Rachel Weisz kanë njoftuar se janë bërë prindër të një vajze. Dy aktorët i kanë

njoftuar miqtë e tyre se janë të lumtur me ardhjen në jetë të fëmijës së tyre. Weisz dhe Craig janë në lidhje që tetë vjet, ndërsa u njoftuan në xhirimet e filmit "Dream House".

## Jennifer Lopezi përgatitet për koncertin në Las Vegas



**A**jo është një nga gratë më të famshme në botë. Jennifer Lopezi, përveç famës në muzikë dhe aktrim, është e njohur edhe për format fizike tejet seksi. J. Lo, pavarë-

sisht prej moshës, ajo e mban trupin mjaft të tonifikuar. Përmes rrjetit social në "Instagram" ajo ka bërë me dije se po përgatitet për koncertin që do ta mbajë në Las Vegas.



## Ariana Grande me fustan të shkurtër në funeralin e Aretha Franklin, nisin kritikën

**A**riana Grande ishte një prej artisteve që këndoi në funeralin e mbretëreshës së muzikës soul, Aretha Franklin. Mirëpo, ndaj saj kanë nisur një sërë sulmesh dhe kritikash, duke e

akuzuar se nuk e ka respektuar funeralin e së ndjerës. Sipas kritikëve, Grande kishte veshur një fustan shumë të shkurtër dhe të ngushtë, i cili, sipas tyre, nuk është i përshtatshëm për një funeral.

## Probleme për T-Pain



**R**eperi që fitoi çmimin Grammy, T-Pain, u arrestua nga policia në Atlanta, pasi u përpoq të kalonte një pikë kontrolli të sigurisë me një armë në aeroportin ndërkombëtar të Hartsfield-Jackson. Sipas informacioneve, arma u gjet në një çantë e cila i përkiste

T-Pain, emri i të cilit është Faheem Rashad Najm. Më pas, T-Pain u dërgua në zonën e policisë së aeroportit. Policia përmes një deklarate ka njoftuar se reperi ka konfirmuar mbajtjen e armës, duke siguruar leje të vlefshme dhe arma më pas iu kthye atij.

Autor: GAZMEND MORINA	SHTET NË EVROPE	PASION PËR T'U DEHUR ME ETER	KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË	MASHKULLI I ROSËS DAFINË (shq.)	DY BASHKË- TINGËLLORE	SHKOP I BILARDOS	RAVENA	PARAARDHËSI YNË	KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE	<b>EPOKA E RE</b>	BETIM					
AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 1 (shqip.)	○	○	○	○	○	○	○	○	○	BASHKËTING. ZIFT						
SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË BLETËRRITËS							PLAKË LLOJ VETURE RUSE									
					QYTET NË KOSOVË KLUB FUTBOLLI ITALIAN						QYTET I VJETËR NË KOSOVË					
ÇMENDJE (bised.)						MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAI VEPËR E JOSIP RELËS										
AMERICA ONLINE			ISTRES I TURPËRUAR (krah.)	LIDHJA E QELIZAVE TË NJËLLOJTA KËNGËTARJA ..... TAKE				RENE RITA ENË QELQI E RRUMBULLAK- ËT ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK								
<b>EPOKA E RE</b>	BREJTËS I VOGËL BASHËTING.		ISH PRESIDENTI SHQIPTAR RAMIZ ..... SIMBOL I FESE MYSLIMANE (shq.)					SHTRESË, PALË AKTORI ÇELAJ								
VETURAT, AUTOMJETET							LUMË NË TIRANË TEFTA TASHKO				DËSHTIM I LINDJES SË FËMIJËS	AJKA E QUMËSHTIT	ELEKTRODË E POLIT POZITIV NË NJË BURIM RRYME (sh.shq.)	ZIANE ORGANIZAT. NATIONAL OHIO	JO I BARDHË	
RASA E PARË E LAKIMIT, EMËRORE (gram.) KËPUÇË PËR RRËSHQITJE MBI AKULL (sh.shq.)										FALJA FETARE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT						
KUSAR					DAULLE	DIREK SHKENCA MBI PAQEN				DRU QË PËRDORET PËR VEGLA MUZIKORE ILION LIKA						
ZANORE		HIT NGA ALTUNA SEJDIU SHENJA QË PARALAJMË- RON DIÇKA					MIRË DE; NË RREGULL (bised.) SHTET FEDERAL NË SHBA KAFSHË PËR NGARKESË E VISEVE TË AMERIKËS JUGORE				GAZ PËR PASTRIMIN E PLAGËVE (shq.) TURK I VJETËR					
FUTBOLLISTI FRANÇESKO (ROMA)				UMA REDFORD EMËR MASHKULLI MYSLIMAN											I DËRGUARI SPECIAL PËR ZGJIDHJEN E NJË KONFLIKTI	
INDIAN GEOPHYSICAL UNION			THIRRJE QË I BËHET TURMËS					BASHKËTING. KALORËS MESJETAR		LLOJ REVOLEJE DEGË E MEKANIKËS			AUSTRIA DY BASHKË- TINGËLLORE	ZANORE ENDE		
HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE (bised.)			QENGJ I BUTË MIMOZA AHMETI					NOTË MUZIKORE KAMBANË E VOGËL (sh.shq.)					SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA ..... ERBIUM			
ABEDIN REXHA			ZVOGËLIM I TEPËRT (sh.shq.) BASHKËTING.											KLINT ISTVUD GJAKATAR		
QYTET I YNI NË MAL TË ZI					DRY AKTORJA HOLLIVUDIANE NË FOTO 2 ..... WATTS								PRODUKT I QUMËSHTIT RRALLË (Lat.)			
<b>2</b>							HOV, VRULL SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE						KËNGËTARJA VALENTINA PARADHËNIA			
							YNDYRË PËR FYTYRË DETERGJENT PËR DUAR						SHTET NË AZI (pashq.) TË HOLLA			
							VEÇORIA THELBËSORE E NJË SENDI ZANORE								IPSVICH SHKRIMTARI MEKULI	
							ZË ME DORË A ME DIÇKA TJETËR LITËR, NIKEL						"LETONIA" KA, DEM		SHKRONJË GREKE	
							NJOLLË (sh.shq.) ALESSANDRO NESTA							SELEN NORA ISTREFI		
<b>EPOKA E RE</b>					NJË PLANET NË SISTEMIN DIELLOR ZANORE					FUSHËBETEJË (sh.shq.) BASHKËTING.						
															PJESË E SYRIT	



ZGJIDHJA E FJALËKRËYQIT: MERIL STRIP, B. ATAKAMA, LOKE, BLETAR, KLINA, TRANIM, ARITA, AO, I, INDI, RR, MI, ALIA, KAT, MAKINAT, LANA, NOMINATIV, NAMAZI, PIRAT, TRA, ABANOZ, A, INATI, ANI, OZONI, TOTI, UR, KOLORADO, IGU, APELL, Z, TT, A, E, NUR, MANAR, DO, STAM, AR, MINIMIZIMET, KI, TIVAR, KATINAR, KOS, NA, ELAN, RAMA, A, KREM, KATAR, OSO, TIPARI, I, MALLI, KAP, LE, IPE, LARAT, SE, URAN, ARENAT, UNANIM, IRIDA.



# Stalini, fëmijëria e trishtuar me të atin pijanec

Stalini i vogël, ka pasur një fëmijëri të trishtuar për shkak të marrëdhënieve të dy prindërve. Babai i tij pijanec e tmerronte. "Biri im Soso ishte një fëmijë shumë i ndjeshëm", tregonte e ëma. "Sapo dëgjonte nga rruga të atin që këndonte, menjëherë turrej drejt meje, duke më kërkuar që të shkonte tek fqinjët dhe priste atje derisa ta zinte gjumi". I ati ushtronte dhunë ndaj të dyve, Stalinit dhe nënës së tij. Njëherë ai e përplasi Stalinit aq dhunshëm në dysheme sa fëmija urinoi gjak për disa ditë. "Rrahjet dhe goditjet që nuk i meritonte, e bënë djalin aq të sertë dhe të pashpirt sa edhe i ati" tregonte një shok i tij i fëmijërisë. Sjellja e të atit do të rrënojste tek ai më vonë urrejtjen ndaj njerëzve. Ndërsa e ëma i jepte shumë dashuri i ati e trajtonte si një qen. Stalini u rrit mes sherreve, zënive dhe grushteve, ashpërsisë dhe agresivitetit. Kështu që u bë shumë e vështirë që ai të kontrollohej. Goditja psikike e të atit po ndikonte direkt tek i biri. Psikologët e lidhin kulturën e dhunës në jetën e Stalinit pikërisht me fëmijërinë e tij. Stalini besonte tek dhuna si "kosa e shenjtë e historisë" edhe si një

mjet menaxhues i domosdoshëm.

Kjo u jepte dorë lakenjve të tij që ti godisnin njerëzit me qëllim që ata mund të kontrolloheshin. Sidoqoftë Stalini e pranon se ka qarë shumë gjatë fëmijërisë së tmerrshme. Gjatë kohës kur ishte fëmijë familja e tij ndërroi 9 shtëpi ndërsa e ëma përpiqej të ndahej nga i atij. Por ai pretendonte se do të ndryshonte dhe ata bashkoheshin sërish. Kur ai nuk po e linte pijen ata u vendosën në shtëpinë e një prifti.

E gjithë kjo situatë do të ndikonte tek i biri. Alkolizimi e bëri atë xheloz patologjik, thashethemet mbi tradhtitë e të shoqes, të cilat i dhanë fund pushtetit të dhënë nga Zoti si një mashkull gjeorgjian si dhe qëndrimi i shumë personave në qytet kundër tij, ndikuan që ai të rrënohej.

Kur Stalini fëmijë e shihte të atin të shtrirë në rrugë të lënë vetëm ai përpiqej ta ngrinte ta merrte për krahu dhe ta çonte shtëpi. "Ai u bë tip i mbyllur shpesh rrinte vetëm dhe nuk bashkoihej të luante me fëmijët e tjerë. Ai thoshte se dëshironte të mësonte të lexonte", kujtonte e ëma. (gazeta-Shqip.com)



## Facebook dëshiron që ne të bëjmë miqësi të reja me të huajt

Rrjeti social po teston në SHBA një veçori për të nxjerrë në pah në komentet e postimeve informacione që përdoruesit e tjerë ndajnë me ne. Por kjo ndodh vetëm për të dhënat e bëra publike në profilin tuaj.

Facebook dëshiron të rrisë ndërveprimet midis përdoruesve dhe për këtë shtyn të rrisë numrin e miqësive të lindura në platformë, duke u fokusuar në aspekte që bashkojnë njerëzit që kurrë nuk kanë parë as njëri-tjetrin. Rrjeti social sapo ka filluar një eksperiment në SHBA të quajtur "gjëra të përbashkëta".

Por nuk thuhet se në të ardhmen nuk mund të arrijë edhe në Europë. Për shembull, përdoruesi që drejton tabelën e tij të buletinit mund të gjejë pranë komentit të një personi nën një postim publik një informacion që ato të dy ndajnë. Mund të jetë qyteti i origjinës ose universiteti i ndjekur, por mund të ndodhë që të regjistrohen në raportet e njerëzve që punojnë për të njëjtën kompani ose vetëm nëse

janë të regjistruar në të njëjtët grupe të Facebook.

Megjithatë, rrjeti social ka theksuar se do të tregojë vetëm informacionin që njerëzit kanë bërë publike në profilin e tyre, në përputhje me cilësimet e privatësisë që secili përdorues ka krijuar për llogarinë e tyre. Por, përpjekja nga platforma e Zuckerberg për të rritur kërkesat e miqve dhe ndërveprimet kuptimplote nuk është e kufizuar në provën e fundit. Iniciativat e tjera përtej seksionit "Njerëzit që mund të njihni", që ofron kontakte të reja në bazë të miqësive të përbashkëta, shoqëria gjithashtu po zgjeron mjete të tjera për të lidhur individë me interesa të ngjashëm të regjistruar në të njëjtat grupe.

Në fillim të gushtit, Facebook njoftoi futjen e një veçorie për të



krijuar kontakte të reja midis mjeshtrove dhe studentëve në fusha të ndryshme të aplikimit. Por, më herët, gjatë konferencës së zhvilluesve të majit, ai tha se donte të fillonte një shërbim online takimesh, që duke përfituar nga sasia e të dhënave në duart e rrjeteve shoqërore, do të iniciojë marrëdhënie kuptimplote

midis individëve që konsiderohen të pajtueshëm.

Rezultati për përdoruesit – Ajo nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me miqësinë midis përdoruesve, por një nga lajmet e fundit mbi eksperimentet e kryera nga Facebook është ai i klasifikimit të përdoruesve me një rezultat nga zero në një për të treguar aftësinë

e tyre për të dalluar lajmet e vërteta nga lajmi i rremë. Në thelb një mënyrë për të kuptuar se si njerëzit janë të besueshëm në raportimin e mashtremeve të mundshme të përhapur në rrjetet sociale, edhe nëse në atë kohë kompania nuk ka sqaruar se në çfarë baze synon të japë një votim për përdoruesit e tij.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE ALMERIA - MALAGA 2 LORIENT - GRENOBLE 1 HOLSTEIN KIEL - MAGDEBURG 1

# Flamurtari valon në elitë

Superliga në futboll vazhdon të jetë mjaft interesante në javët e para, kurse Flamurtari është dominues me tri fitore në po kaç ndeshje. Fitores së parë iu gëzua edhe skuadra e Feronikelit, kurse Llapi ishte bindës përballë Ferizajt (5-1)



**IPKO SUPERLIGA - JAVA E TRETË**

Flamurtari-KEK-u	1-0
Gjilani-Trepça '89	1-0
Feronikeli-Ballkani	1-0
Llapi-Ferizaj	5-1
Liria-Drita	3-2

**Tabela**

1. Flamurtari	9 pikë
2. Llapi	6
3. Gjilani	6
4. Drenica	4
5. Feronikeli 5	
6. Prishtina	3
7. Drita	3
8. Liria	3
9. Ballkani	3
10. Ferizaj	3
11. Trepça '89	1
12. KEK-u	0

Në xhiron e radhës takohen: KEK-u-Trepça '89, Drenica-Gjilani, Ballkani-Prishtina, Ferizaj-Feronikeli, Drita-Llapi, Flamurtari-Liria.

**LIGA E PARË**

Istogu - Vllaznina (P)	4-1
2 Korriku - Vëllanzimi	0-3
Fushë Kosova - Trepça	2-0
Vushtrria - Arbëria	2-1
Dukagjini - Ramiz Sadiku	3-2
Bashkimi - Kika	2-2
Besa - Vitia	5-1
Drenasi - Onix	0-1

**Tabela**

1. Napoli	6 pikë
2. Onix	6
3. Dukagjini	6
4. Besa	4
5. Kika	3
6. Istogu	3
7. Arbëria	3
8. Fushë Kosova	3
9. Vushtrria	3
10. Drenasi	3
11. Vitia	3
12. Vllaznina	1
13. Ramiz Sadiku	0
14. Bashkimi	0
15. Trepça	0
16. 2 Korriku	0

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Flamurtari i Prishtinës vazhdon të jetë befasia më e këndshme e IPKO Superligës në futboll, pasi e ka regjistruar edhe fitoren e tretë në këtë edicion dhe është kryesues i elitës me nëntë pikë. Skuadra kryeqytetase të dielën ka shënuar fitore mjaft të vështirë në ndeshjen ndaj KEK-ut me rezultat 1-0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Agron Bruqi në minutën e 81-të, kurse mysafirët në trembëdhjetë minutat e fundit luajtën pa një lojtar, pasi Rilind Namani u ndëshkua me karton të kuq. Në ndeshjen tjetër Gjilani e ka mposhtur me rezultat 1-0 Trepçën '89. Kjo e fundit ishte një ndeshje e vërtetë derbi, kurse golin e fitores për vendësit e shënoi Trevin Caesar (32). Llapi është treguar skuadër tepër e

fortë të shtunën ndaj Ferizajt, pasi ka shënuar fitore me rezultat bindës 5-1. Ahmet Januzi e hapi serinë e golave për vendësit në minutën e 11-të, kurse Zhdrella dhe Idrizi shënuan dy golat e tjerë në pjesën e parë për rezultatit 3-0. Në fillim të pjesës së dytë Florim Berbatovci e shënon golin e parë dhe të vetmin për skuadrën mysafire. Në anën tjetër, vendësit vazhduan të dominojnë në ndeshje dhe realizuan edhe dy gola të tjerë nëpërmjet sulmuesit Fiton Hajdari. Në ndeshjen e zhvilluar në Drenas, Feronikeli doli të jetë fitues ndaj Ballkanit (1-0). Në këtë mënyrë paralajmërimi i sulmuesit Kastriot Rexha para kësaj ndeshje, se do të shënojë dhe se Feronikeli do t'i gëzohet fitores, edhe doli. Kjo ishte fitorja e parë për skuadrën e "Niklit" në këtë kampionat, kurse Ballkani nga prej tri ndeshjeve pësoi dy humbje.

**Shkurt**

**Mustafi shënoi dhe festoi me shqiponjë**

Shkodran Mustafi ka shënuar golin e parë të Arsenalit në ndeshjen ndaj Cardiff Cityt (2-3). Shqiptari Mustafi e shfrytëzoi një pasim të Granit Xhakës dhe e dërgoi topin në rrjetë vetëm pesëmbëdhjetë minutave lojë. Mustafi pas golit të shënuar festoi me shqiponjë, derisa duhet cekur se në pjesën e dytë Xhaka u ndëshkua me karton të verdhë.

**U19-shat grumbullohen nga 5 deri më 8 shtator**

Menaxheri i Përfaqësueses së Kosovës U19 në futboll, Rinor Havolli, ka bërë me dije se U19-shat do të grumbullohen nga 5 shtatori deri më 8 shtator para ndeshjeve kualifikuese që do të zhvillohen më 10 tetor deri më 16 tetor në Hungari. Për këtë grumbullim përzgjedhësi Ramiz Krasniqi ka ftuar 27 futbollistë, por ka mundësi të ftohen edhe futbollistë të tjerë.

**Rashica: Ja si shënova nga gjuajtja e lirë**

Milot Rashica sërisht tërhoqi vëmendjen dhe ishte vendimtar për ekipin e vet Werder Bremen. Anësori i Werder Bremenit hyri në fund të takimit në lojë, për ta bërë ndryshimin dhe në sekondat e fundit shënoi nga gjuajtja e lirë për ta mposhtur Eintracht Frankfurtin 1 me 2. Në gjuajtjen e lirë ai rrëfen se si kapiteni kërkoi prej tij gol pasi e mori përgjegjësinë për të ekzekutuar. "Ishte pozicioni i duhur për të djathtën time. Kapiteni më tha se nëse do të gjuaj atëherë duhet të shënoj, pasi që dua ta ekzekutoj gjuajtjen e lirë. Goli ishte për tifozët dhe për Pavlenkan. Ishte keq që e pashë atë të shtrirë. Kjo fitore na bën vërtet mirë", ka thënë Rashica.

**Taulant Xhaka ndëshkohet me të kuq**

Taulant Xhaka u ndëshkua me karton të kuq në ndeshjen në mes të Baselit dhe Thunait, e cila përfundoi 1-1. Xhaka fillimisht në minutën e 19 u ndëshkua me karton të verdhë, kurse në fund të pjesës së parë u zverdh sërisht dhe u përjashtua nga loja. Në këtë mënyrë Baseli e ruajti rezultatit 1-1 deri në fund të ndeshjes.

**Mourinho pengoi rikthimin e CR7 në United**

Cristiano Ronaldo është futbollist i Juventusit, një lëvizje që shkaktoi shumë bujë këtë verë. Ai e kishte vendosur me kohë largimin nga Real Madridi, por destinacioni ngelej enigmë. Manchester Unitedi dëshironte shumë që ta rikthente portugezin por, sipas asaj që ka konfirmuar e përditshmja "Mirror", ka qenë Mourinho ai që ka frenuar gjithçka. Sipas trajnerit, nuk kishte kuptim që Unitedi të paguante 100 milionë euro për një 33-vjeçar, pavarësisht se kush është ai. Mourinho kërkonte t'i shpenzonte ato para për një mbrojtës të cilin nuk e mori dot.

**Ballkani miraton dorëheqjen e Shotanit**

SUHAREKË, 2 SHTATOR - Bekim Shotani ka dhënë dorëheqje nga detyra e trajnerit të ekipit nga Suhareka, Ballkani, ndërsa dorëheqja e tij është pranuar nga kryesia e klubit. Ballkani e nisi pozitivisht sezonin duke shënuar fitore në udhëtim në xhiron e parë ndaj Lirisë me rezultat 1-0. Megjithatë, në ndeshjen e

dytë në shtëpi humbi thellë nga Llapi, teksa u mposht edhe në xhiron e tretë nga Feronikeli. "Pas humbjes me Feronikelin, trajneri ynë i deritashëm, Bekim Shotani, ka dhënë dorëheqje. Ne si klub i jemi shumë mirënjohës për punën e shkëlqyer të deritashme. Jemi mirënjohës në të gjitha aspektet profesionale dhe njerëzore. Futbollit është i tillë dhe duhet të pajtohemi me ndërime, fitore dhe humbje. Klubi ka nevojë më shumë se çdoherë për përkrahjen e qytetit dhe të dashamirëve. Për gjithçka rreth ndryshimeve do t'ju informojmë me kohë", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

sionale dhe njerëzore. Futbollit është i tillë dhe duhet të pajtohemi me ndërime, fitore dhe humbje. Klubi ka nevojë më shumë se çdoherë për përkrahjen e qytetit dhe të dashamirëve. Për gjithçka rreth ndryshimeve do t'ju informojmë me kohë", thuhet në njoftimin e Ballkanit.




## Drejtori i përgjithshëm i Crvena Zvezdës: Shaqiri e di se ku do të vijë

BEOGRAD, 2 SHTATOR - Xherdan Shaqirit i rezervoi shorti një grup të vështirë, ku përballë do të ketë skuadrën e PSG-së, të Napolit dhe të Crvena Zvezdës. Ndeshja me këtë të fundit do të jetë disi e veçantë, pasi Shaqiri do të shkojë në Beograd dhe

atje nuk do të jetë i mirëpritur. Ndërkohë në lidhje me provokime të mundshme nga lojtari me origjinë shqiptare, drejtori i përgjithshëm i skuadrës së Crvenës së Zvezdës ka thënë: "Nuk besoj. Mendoj se ai do të jetë nën presion të madh

psikologjik sepse e di se ku vjen. E di se Crvena Zvezda është simbol i Serbisë, ndërsa do të luaj në Marakanën e nxehtë. Nuk e di nëse do të vijë njëherë. Normalisht, si klub futbollit patjetër duhet të presim njëloj çdo rival tonin. Nuk

duhet të merremi me të kaluarën dhe historinë. Crvena Zvezda duhet patjetër të ndiejë se Shaqiri ka ardhur të luajë futboll. Detyra jonë është ta mbrojmë nga situata të padëshiruara. Të jemi pritës të mirë!"



## Hamiltoni triumfoi në Itali

ROME, 2 SHTATOR - Lewis Hamiltoni me Mercedesin fitoi garën e Çmimit të Madh të Italisë në Formula 1, sukses i merituar i pilotit britanik, që bëri një garë në sulm dhe korri një fitore që e afron gjithnjë e më shumë me titullin kampion. Ai përfitoi edhe nga gabimet e rivalëve të vet, kryesisht të Sebastian Vettelit, që në kthesat e para të garës nuk evitoi dot një kontakt me Hamiltonin dhe gjermani e mbylli garën i katërti pasi përfundoi në vendet e fundit. Mbi të gjitha, piloti i Mercedesit arriti ta mposhtë Kimi Raikkonenin me makinën tjetër Ferrari, që e kryesoi garën në shumicën e kohës, por u detyrua ta hapë krahun tetë xhiro nga fundi. Finlandezi u rendit i dyti, ndërsa i treti u rendit Valtteri Bottas me makinën tjetër Mercedes. Edhe pse Ferrari ishte favorit për ta fituar garën e shtëpisë, pasi garonte para fansave të vet në pistën e Monzas dhe e nisi atë me dy pilotët e saj në vijën e parë të startit, nuk festoi dot. Mercedesi u tregua më konkret në pistë, arriti të jetë o saktë në çastet vendimtare dhe e meritoi fitoren. Ndërkohë që Vetteli mbetet zhgënjimi më i madh i garës, pasi u rendit i katërti edhe pse rikuperoi shumë pozicione pas kontaktit në start, por



ndoshta ishte vetë fajtor. Gara nisi me një kontakt mes Hamiltonit dhe Vettelit që në kthesat e para, me ferraristin që detyrohet ta hapë krahun dhe përfundon në fundin e renditjes, pasi dëmton njëvendëshen e tij dhe në pistë hyn makina e sigurisë. Britaniku me Mercedes parakalon edhe Raikkonenin pas daljes së makinës së sigurisë, por finlandezi kundërpërgjigjet dhe rimerr kreun që e humbi vetëm për pak metra. Ndërkohë që, nga vendet e fundit, Vetteli nis rikuperimin dhe pas 15 xhirosh është i dhjeti në renditje. Pas xhiros së 20-të nisin ndalesat e para dhe hap serinë Raikkoneni, që ndërton gomat, por jo Hamiltoni dhe pilotët e tjerë, që qëndrojnë në pistë dhe hyjnë në bokse pas disa xhirosh. Vetteli garon si i çmendur dhe kap

vendin e pestë, ndërkohë që "dorëzohet" Daniel Ricciardo, që ka probleme me makinën dhe tërhiqet nga gara. Për disa xhirova gara është e qetë, me Raikkonenin që kryeson ndaj Hamiltonit, por pa u shpëputur dhe tetë xhiro nga fundi vjen parakalimi i britanikut, që merr kreun dhe e ruan atë deri në fund, duke triumfuar në shtëpinë e "kokëkuqes". Duel i fortë për vendin e tretë, me Verstappenin që e mbyll garën para Bottas, por holandezi i Red Bullit penalizohet me pesë sekonda për një kontakt mes tyre disa xhiro më parë dhe dorëzon dy pozicione (renditet i pesti). Ndërsa Vetteli renditet i katërti dhe humbet shumë terren karshi britanikut në renditjen e përgjithshme, tashmë -30 pikë pas Hamiltonit.

## Eliminohet Kerberi, kalojnë Federeri dhe Djokoviçi

LONDËR, 2 SHTATOR - Surpriza e radhës në turneun "US Open" u regjistrua sërish në garimin e femrave. Angelique Kerber, që është numri 4 i botës, u eliminua në raundin e tretë në turneun njujorkez nga Cibulkova. Tenistja slovake arriti të fitojë ndaj gjermanes 2-1, në një ndeshje që u duk sikur ishte në kontrollin e Kerberit. Kjo e fundit fitoi në fakt setin e parë 6-3, por më pas gjeti kundërpërgjigjen e Cibulkovës, e cila fitoi dy setet e tjerë me rezultat të njëjtë 6-3, duke prerë biletën për në 1/8-at e finaleve. As Maria Sharapova nuk gaboi, e tashmë e sheh veten mes 16 më të mirave të turneut. Tenistja ruse mundi në raundin e tretë letonezen Jelena Ostapenko, me rezultatin 2-0. Ajo e djeshmja ishte një sfidë ku Sharapova duket se nuk e vuri në asnjë moment në dyshim fitoren, duke i mbyllur setet me rezultatin 6-3 dhe 6-3. Kundërshtarja e radhës së Sharapovës do të jetë



spanjollja Carla Suarez Navarro, që eliminoi francezen Caroline Garcia. Për meshkuj, Roger Federer dhe Novak Djokoviçi vijojnë aventurën e tyre në "Flushing Meadows". Tenisti zviceran kaloi në 1/8-at e finaleve pasi mundi në raundin e tretë Nick Kyrgios. Në moshën 37-vjeçare, Federeri e zgjidhi shumë lehtë përballjen me Kyrgios, duke e mbyllur atë me rezultatin 3-0, me sete 6-4, 6-

1 dhe 7-5. Ndërkohë, Novak Djokoviçi kaloi mes 16 më të mirëve të turneut pasi eliminoi francezin Richard Gasquet. Tenisti serb shpenzoi 2 orë e 11 minuta lojë në këtë sfidë, të cilën e fitoi me rezultatin 3-0 me sete 6-2, 6-3 dhe 6-3. Djokoviçi do të përballlet në raundin tjetër të "US Open"-it me portugezin Sousa për ta siguruar kalimin në çerekfinale.

### SHKURT

#### Ronaldinho: Barça ta pensionojë fanellën me numër 10

Ish-sulmuesi i Barcelonës, Ronaldinho, mendon se fanella me numër 10 që mban Lionel Messi te skuadra "blaugrana" duhet të tërhiqet, pasi askush tjetër nuk meriton ta mbajë veshur atë pasi argentinasi të lërë sportin. "Messi e ka nderuar më shumë se kushdo tjetër atë fanellë dhe atë numër. Nuk kam asnjë dyshim për këtë. Është lojtari më i mirë i historisë së këtij klubi. Në gjithë këto vite ka bërë atë që nuk e ka realizuar askush tjetër. Është më i miri", ka thënë Ronaldinho. "Unë shpresoj që ai të luajë edhe për 20 vjet të tjera. Për ne që e duam futbollin duam që të shohim sa më shumë kampionë të tillë për një kohë të gjatë. Unë nuk di të them nëse Messi është më i mirë i historisë së futbollit, pasi ka shumë kampionë që kanë bërë emër në epokën e tyre. Por Messi është një nga më të mëdhenjtë në histori dhe kur ai të largohet, fanella me nr. 10 te Barcelona duhet të tërhiqet", ka deklaruar Ronaldinho.

#### Daliqi: Ronaldo është egoist

Trajneri i kombëtares kroate, Zlatko Daliq, mbron kapitenin e vet Luka Modriq, i shpallur lojtari i vitit nga UEFA dhe sulmon Cristiano Ronaldon. "Nuk ia vlen që unë të flas. Mungesa e tij në ceremoninë e UEFA-s dhe ato komente që çmimin e fitoi Modriqi tregojnë atë që unë e them prej kohësh: Ronaldo është një egoist dhe nuk do ta doja kurrë në skuadrën time. Është ai lloj lojtari që mendon vetëm se 'nuk ka rëndësi nëse humbasim, e rëndësishme është që unë të shënoj'", ka thënë Daliq, i cili zbuloi se ishte surprizuar nga tërheqja e Mandzukiqit nga kombëtarja, pasi vetëm 24 orë përpara vendimit kishte folur me të dhe nuk i kishte thënë asgjë.

#### Courtois: Navasi dhe unë jemi shokë

Portieri i Real Madridit, Keylor Navas, ndeshjet e mbrëmshme kundër Leganes ishte i ulur në bankën rezervë pasi që në formacionin e parë, në vend të tij, ishte portieri i ri, Thibaut Courtois, i cili debutoi për skuadrën e vet të re. Pas ndeshjes, e cila përfundoi me rezultat 4-1, Courtois sqaroi se ai ka marrëdhënie shumë të mirë me portierin tjetër të "Los Blancos", Navas. "Keylor Navas dhe unë jemi shokë. Nganjëherë e shoh se mediet dëshirojnë të krijojnë lajme kontroverse, por që të dy jemi duke garuar për vendin e parë dhe stërvitemi së bashku deri në maksimum. Gara bën që ti të japësh më shumë nga vetja. Në çdo klub të madh të botës ka garë për secilën pozitë", ka thënë Courtois.

#### Sarri lavdëron Marcos Alonson

Trajneri i Chelsea, Maurizio Sarri, ka ngritur në qiell spanjollin duke thënë se Marcos Alonso është mbrojtësi më i mirë i krahut të majtë në Evropë. "Alonso është ndoshta më i mirë në Evropë në pozitën e tij. Fizikisht shumë i përgatitur dhe po kontribuon shumë në fazën ofanzive. Ndoshta duhet të përmirësohet pak sa i përket fazës së mbrojtjes", ka thënë Sarri. Alonso ka shënuar 14 gola që nga ardhja në Premierligë dhe është mbrojtësi që ka kontribuar në më së shumti gola në Premierligë (prej kur është pjesë e saj).

#### Pogba kërkon largimin nga Unitedi

Mediet angleze raportojnë se ylli francez i Manchester Unitedit, Paul Pogba, u ka kërkuar drejtuesve largimin nga "Old Trafford", ku nuk po kalon një periudhë aspak të mirë, për shkak edhe të marrëdhënieve me Jose Mourinhon. Mësohet se Pogba ka kërkuar të rikthehet sërish në Itali, te Juventus, skuadër ku edhe shkëlqeu gjatë periudhës 2012-2016, duke shënuar 28 gola në 124 ndeshje dhe duke tërhequr vëmendjen e gjithë botës së futbollit. Mesfushori francez kërkon të rikthehet në Torino që gjatë merkatos së janarit, i ndikuar edhe nga prania e Cristiano Ronaldos aty, bashkë me të cilin kërkon të triumfojë në Ligën e Kampionëve. Vetë formula e Championsit këtë sezon e lejon Pogban që, pavarësisht se do të luajë në fazën e grupeve me Manchester Unitedin, të luajë në fazën me eliminim me një tjetër skuadër, nëse vendos të ndërrojë ambient në janar.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council

Sekretariati - Sekretarijat - Secretariat

Në përputhje me nenin 14A të Ligjit Nr. 05/L-035 të datës 25 maj 2015, Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas nenit 36 e 37 të Rregullores së KPK-së Nr. 10/2015 të datës 29 dhjetor 2015, Për Organizimin dhe veprimtarinë s Këshillit Prokurorial, dhe Funkcionin Mbështetës Administrativ të Sekretariatit dhe Drejtorit të SKPK-ës, nenin 18, i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, e në përputhje me nenin 3 pika 7, nenin 30 paragrafi 1, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, rishpall këtë :

## KONKURS

1. Zyrtar për Përkthim „Një (1) pozitë në Zyren e Kryeprokurorit të Shtetit (Shqip - Anglisht dhe anasjelltas)

Referenca :	SKPK/ZKPSH POZ- 07
Emri Pozitës:	Zyrtar për Përkthim
Niveli:	Niveli Profesional 2
Kodi punës:	IN/040 DU+2
Grada punës:	9
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Periudha provuese:	12 Muaj
Vendi:	Prishtinë

## Qëllimi i vendit të punës:

Ofron përkrahje të gjerë në shërbime të përkthimeve - me shkrim dhe simultan për nevojat e Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe për njësitë tjera sipas nevojës.

## Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Bën përkthim profesional të materialeve të shkruara nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas.
- Bën përkthim profesional simultan në takime të niveleve të ndryshme në Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- Përgjegjës për respektimin e afateve dhe për saktësinë e përkthimeve që kryen;
- Merr përgjegjësi specifike lidhur me përkthimin e materialeve që kërkohen nga institucioni;
- Është përgjegjës për përkthimin e dokumenteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit të njejtave;
- Kontrollon/Lektoron materialet e përkthyer dhe është përgjegjës për përkthim cilësor, si me shkrim, konsektiv dhe simultan;
- Mbanë evidencën e saktë e të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, përfshirë përgatitjen e raporteve për tërë punën e kryer;
- Kryen edhe detyra tjera të punës në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

## Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

- Shkathtësi të shkëlqyera të njohjes së gjuhës angleze gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim,
- Njohuri të mirë në të shkruar të gjuhës Shqipe dhe Angleze ;
- Njohuri të terminologjisë juridike,
- Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel, Internet) .

## Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Filologjik - Gjuhë Angleze ose Shkenca shoqërore .

## Përvoja e Punës:

- Dy vite përvojë pune .

Konkursi i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në Ueb faqe zyrtare të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data e publikimit më 03.09.2018 gjer më datën 17.09.2018 si ditë e mbylljes së konkursit.

## Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, të të gjitha komuniteteve.

**Paraqitja e kërkesave:** Formulari për aplikim mund të merret në receptionin e ndërtesës të Prokurorit të Shtetit adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n. apo mund të printohen nga [www.psh-ks.net](http://www.psh-ks.net) apo [www.rks-psh.org](http://www.rks-psh.org).

**Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 gjer në ora 16:00,** në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati i 7 - të, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë;

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të kërkuar:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës;
- Dy - rekomandime ( nëse keni );
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetim.

Data e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të: Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council

Sekretariati - Sekretarijat - Secretariat

U skladu sa članom 14A Zakona Br. 05/L-035 datuma 25 maj 2015, o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-224 o Tužilačkom Savetu Kosova prema članu 36 i 37 Pravilnika TSK-a Br. 10/2015 datuma 29 decembar 2015, O Organizovanju i delatnošću Tužilačkog Saveta Kosova i Administrativnoj Pomoćnoj Funkciji Sekretarijata i Direktora STSK-a, članu 18 Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa članom 3 tačka 7, članom 30 stav 1, Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, ponovno objavljivanje :

## KONKURS

1. Službenik za Prevode, Jedna (1) pozicija na Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova (albanski - engleski i obrnuto)

Referenca :	SKPK/ZKPSH POZ- 07
Naziv Pozicije:	Službenik za Prevode
Nivo:	Profesionalni Nivo 2
Kod rada:	IN/040 DU+2
Stepen rada:	9
Izveštava kod:	Administratoru Tužilaštva
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Koeficijent:	Sedam (7)
Akt imenovanja:	Bez ročno
Probni period:	12 Meseci
Mesto:	Priština

## Cilj radnog mesta:

Pružna širu podršku u uslugama ismenog i usmenog prevodenja o potrebama Kancelarije Glavnog Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova, i za ostale jedinice prema potrebi.

## Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja stručni prevod pisanih materijala sa albanskog jezika na engleskom jeziku i obrnuto.
- Vrši profesionalan simultani prevod u sastancima raznih nivoa u Kancelariji Glavnog Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova.
- Odgovoran za poštovanje rokova i o tačnosti obavljenih prevoda;
- Preduzima specifične odgovornosti u vezi predodjenja materijala koji se zahtevaju od institucije;
- Odgovoran je za prevodenje dokumenata i držanja istih u konfidencialnost;
- Kontroliše/Lekturiše prevodene materijale i odgovoran je za kvalitetan pismeni, konsektivni i simultani prevod;
- Vodi tačnu i potpunu evidenciju aktivnosti, dosijea, radova, službenih dokumenata, uključujući pripremu izveštaja za celokupni obavljani rad;
- Obavlja o ostale obaveze u skladu sa trenutnim zakonima i pravilnicima koje se mogu zahtevati povremeno na razuman način.

## Znanja, veštine i sposobnosti u radnom mestu:

- Odlčne sposobnosti poznavanja engleskog jezika tokom usmene i pismene komunikacije;
- Odlčno poznavanje Albanskog i Engleskog jezika u pisanju;
- Poznavanje pravne terminologije;
- Poznavanje rada sa kompjuterom (MS Word i MS Excel, Internet) .

## Profesionalna priprema i kvalifikacija:

- Univerzitetska Diploma, Filološki Fakultet - Engleski Jezik ili Društvene Nauke.

## Radno Iskustvo:

- Dve godine odgovarajućeg profesionalnog radnog iskustva.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenim Veb stranicama Državnog Tužilaca i Tužilačkog Saveta Kosova, kao i u dnevnoj štampi, počevši od dana objavljivanja 03.09.2018 do 17.09.2018 kao dan zatvaranja konkursa.

## Uslovi za učestvovanje u konkursu:

Pravo na apliciranje imaju svi građani Republike Kosova punoletnog uzrasta koji imaju potpunu sposobnost delovanja, poseduju građanska i politička prava, imaju potrebnu obrazovnu sposobnost i profesionalnu sposobnost za obavljanje zadatka i koji imaju fizičke sposobnosti koje se zahtevaju za odgovarajuću poziciju.

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pozdravlja apliciranja osoba oba pola iz svih zajednica.

Dostavljanje aplikacija: Formular za apliciranje može se dobiti u recepciji zgrade Državnog Tužioca adresa: Ulica: "Luan Haradinaj" b.b. ili može se isprintati preko <http://kpk-rks.org/> ili <http://www.psh-ks.net/>.

Aplikacije se dostavljaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji za Ljudske Resurse, sprat 7, Kancelarija Br. 702, Priština, Kosova;

Ako vam je potrebno kontaktirajte na tel: 038 / 200 18874 od 08:00 - 16:00.

Aplikaciji treba priložiti kopije tražene dokumentacije:

- Dokaz o obrazovnim kvalifikacijama;
- Dokaz o radnom iskustvu, Potvrda ili Ugovor rada;
- Dve preporuke - (ako imate);
- Kopije od dva uzastopna poslednja izveštaja o vrednovanju rada (ako postoji takvo);
- Dokumenti identifikacije - fotokopirana lična karta.
- Uverenje od Suda da niste pod istragom.

Datum održavanja pismenog testa i intervjuja, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni ovim konkursom, biće objavljeni samo u službenim veb stranicama Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova.

Institucija Tužilačkog Saveta Kosova i Državni Tužilac služi svim građanima Kosova i podržava apliciranje osoba oba pola svih zajednica na Kosovu.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati - Sekretarijat - Sekretariat

Në bazë të nenit 14A të Ligjit Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas nenit 36 e 37 të Rregullores Nr. 10/2015 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, nenin 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, e në përputhje me nenin 3 pika 7, nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

### KONKURS

1. Prokuroria Themelore Prishtinë - një (1) pozitë
2. Prokuroria Themelore Mitrovicë -një (1) pozitë
3. Prokuroria Themelore Pejë - një (1) pozitë

REFERENCA	Kodi: SKPK/PTH/ POZ - 009
Emri Pozitës:	Referent i lartë
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional 2
Kodi punës:	DR/ 850 DU+2
Grada punës:	9
Numri i Pozitave:	Tri (3) pozita
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa Afat
Vendi:	Prishtinë, Mitrovicë, Pejë

#### Qëllimi i vendit të punës:

Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike lidhur me lëndët e pranuar në njësinë organizative ku është punësuar, mban evidencën të sakta dhe me kohë në regjistrin e regjistrimit të lëndëve dhe regjistrin e çregjistrimit të lëndëve sipas kërkesave të specifikuar të vetë regjistrin, kujdesi për lëndët dhe shkresat e lëndëve.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Regjistrin me kohë lëndët në regjistrin e pranimit të lëndëve me të gjitha të dhënat që kërkohen sipas regjistrin duke mbajtur evidencën të sakta të lëndëve dhe shkresave të lëndës duke e mbajtur edhe evidencën elektronike;
2. Çregjistrin lëndët dhe mban evidencën të sakta në regjistrin përkatës dhe në mënyrë elektronike, mban evidencën për lëndët specifike dhe të rëndësishme të veçantë, duke vepruar me vetë-iniciativë dhe pa mbikëqyrje të drejtpërdrejtë.
3. Përgjegjës për afate dhe saktësi të punës;
4. Mbikëqyrë sistemin e përcjelljes së lëndëve dhe menaxhon me lëndët sipas punës së ngarkuar;
5. Kontrollon lëndët dhe lëvizjen e tyre brenda institucionit, duke qenë në gjendje që në çdo kohë ta sigurojë lëndën për përfaqësim në Gjykatë;
6. Mban evidencën të sakta e të plota lidhur me dosjet dhe shkresat e lëndëve, akteve, shkresave dhe dokumenteve tjera zyrtare, përfshirë edhe përgatitjen e raporteve për punën e kryer në periudha të caktuara raportuese;
7. I gatshëm për kryerjen e çdo detyre tjetër si referent në shkrime në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale;
8. Kryen edhe punë tjera të lidhura me punën e referentit të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohë.

#### Njohuritë,shkathësitë aftësitë për vendin e punës:

- Shkathësi të mirë komunikimi me shkrim dhe me gojë,
- Aftësi të rregullimit dhe të ruajtjes së kujdesshme të dosjes së lëndëve dhe shkresave,
- Aftësi të punës dhe në mënyrë ekipore,
- Shkathësi të mira të punës me kompjuter (Word dhe Excel).

#### Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Shkenca Sociale, Administratë Publike.

#### Përvoja e Punës:

- Së paku dy vite përvojë pune .

Konkursi i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në [Ueb faqe](#) zyrtare të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data e publikimit më 03.09.2018 gjer më datën 17.09.2018 si ditë e mbylljes së konkursit.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në Shpallje:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike që kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe përvojën e punës profesionale për pozitën e shpallur.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, të të gjitha komuniteteve.

**Paraqitja e kërkesave:** Formulari për aplikim mund të merret në receptionin e ndërtesës të Prokurorit të Shtetit adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n. apo mund të printohen nga [www.rks-psh.org](http://www.rks-psh.org),

**Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 gjer në ora 16:00,** në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati i 7 - të, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë;

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të kërkuar:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës;
3. Dy - rekomandime ( nëse keni );
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
5. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Certifikata që nuk jeni nën hetime.

Data e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të: Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati - Sekretarijat - Sekretariat

U skladu sa članom 14A Zakona Br. 05/L-035 datuma 25 maj 2015, o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-224 o Tužilačkom Savetu Kosova, direktor Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova na osnovu člana 36 i 37 Pravilnika TSK-a Br. 10/2015 datuma 29 decembar 2015, za Organizovanje i Delatnost Tužilačkog Saveta, i Podržnu Administrativnu Funkciju Sekretarijata i Direktora SKPK-a, člana 18, Pravilnik Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi Kosova, a u skladu sa članom 3 tačka 7, članom 30 stav 1, Zakona o Civilnoj Službi Kosova, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

### KONKURS

#### Viši Referent

1. Osnovno Tužilaštvo u Prištini - jedna (1) pozicija
2. Osnovno Tužilaštvo u Mitrovica - jedna (1) pozicija.
3. Osnovno Tužilaštvo u Peć - jedna (1) pozicija.

REFERENCA	Kodi: SKPK/PTH/ POZ - 009
Naziv Pozicije:	Viši Referent
Pozicija:	Pozicija od karijere
Nivo:	Profesionalni 2
Radni Kod:	DR/ 850 DU+2
Radni Stepen:	9
Broj Pozicija:	Tri (3) pozicija
Koeficijent:	Sedam (7)
Akt imenovanja:	Bezročno
Mesto:	Priština, Mitrovica, Peć

#### Cilj radnog mesta:

Pružiti širu administrativnu i tehničku podršku u vezi primljenih predmeta u organizativnoj jedinici gde je zapošljen/a, vodi tačne i blagovremene evidencije u registru za upisanje predmeta i registru za otpisanje predmeta na osnovu specifikovanih zahteva samog registra, vođenje računa o predmetima i spisa predmeta.

#### Glavne Obaveze i Odgovornosti:

1. Blagovremeno registruje predmete u registru za prijem predmeta sa svim podacima koji se traže na osnovu registra voditi tačne evidencije predmeta i spisa predmeta uz uvodenje elektronske evidencije;
2. Otpisuje predmete i vodi tačne evidencije predmeta u odgovarajućem registru i elektronskim putem, vodi evidencije o specifičnim predmetima i onih od posebne značajnosti, postupajući samo-inicijativno i bez direktnog nadzora;
3. Odgovoran za rokove i radne preciznosti;
4. Nadgleda sistem praćenja predmeta i upravlja sa predmetima na osnovu radnog opterećenja;
5. Kontrolise predmeta i njihovo kretanje unutar institucije, uz spremnost da u svakom trenutku obezbedi predmet za zastupanje u Sudu;
6. Vodi tačne i potpune evidencije u vezi dosijea i spisa predmeta, akata, ostalih službenih spisa i dokumenata, uključujući i pripremanje izveštaja o obavljenom radu u određenim izveštajnim periodima;
7. Spreman za obavljanje svake druge obaveze kao referent u pisarnici u skladu sa važećim zakonima i propisima;
8. Obavlja i ostale poslove u vezi sa radom referenta koje se mogu povremeno razumno zahtevati.

#### Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

- Dobre pismene i usmene komunikativne veštine,
- Sposobnosti za uređivanje i pažljivog sačuvanja dosijea i spisa predmeta,
- Sposobnost da radi samostalno i u timskom radu,
- Dobre sposobnosti rada kompjuterom (Word i Excel).

#### Stručna sprema i kvalifikacija:

- Univerzitetska Diploma, Društvene Nauke, Javna Uprava.

#### Radno Iskustvo:

- Najmanje 2 godine radnog iskustva.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objave na [Ueb stranici](#), ili na nekom od dnevnih novina, počev od dana 03.09.2018 do 17.09.2018, koji dan se smatra poslednjim danom zaključenja konkursa.

#### Instrukcije Aplikiranja:

Zahtev (Aplikacija) za zaposlenje nalazi se na Ueb stranici: [www.psh-ks.net](http://www.psh-ks.net) apo [www.rks-psh.org](http://www.rks-psh.org), te nako ispunjavanja svake tačke u aplikaciji, priložite potrebnu dokumentaciju koja se traži po konkursu.

**Aplikacija i dokumentacija predaje se kod:** Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova / Divizija Ljudskih Resursa, ulica « Luan Haradinaj » b.b. Zgrada Državnog Glavnog Tužioca, blizu NEWBORN, sprat 7, kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.

**PAŽNJA:** Nepridržavanje zahtevima za popunu aplikacije i nedostavljanje tražene dokumentacije kako je traženo u Aplikaciji i Konkursom, Aplikacija će se smatrati nekompletnom i neće se uzeti na razmatranje.

U slučaju potrebe za svaku nejasnoću možete nas kontaktirati telefonom na brojeve: 038 / 200 18 874 Od 08:00 - 16:00 časova.

Aplikaciji treba dpriložiti kopiju dokumenata:

1. Dokaz o obrazovnim kvalifikacijama.
2. Dokaz o random iskustvu, Potvrda, Ugovor o radu, Akt Imenovanja,
3. Dokaz za plaćanje u Trusti za radno iskustvo.
4. Dve - Preporuke ( ukoliko ih imate ).
5. Kopije dva zadja uzastopna vrednovanja posla (ako ista postoje).
6. Dokument identifikacije, važeća lična karta
7. Uverenje da niste pod istragom od Suda

Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće selektirani za užu listu i biće pozvani na pismeno testiranje, oni koji prodju pismeno testiranje biće pozvani na usmeno testiranje. Informisanje će se obaviti putem telefona ili preko službene Ueb stranice od strane Ljudskih Resursa.

„Civilna Služba Kosova služi svim stanovnicima Kosova, podržavamo Aplikiranje žena i muškaraca svih zajednica Kosova“.





## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Master Lease", L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 71329364 dhe nr.fiskal: 601698915 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Master Lease", L.L.C. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 71329364 i broj fiskala: 601698915 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Master Lease", L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 71329364, i number fiskal: 601698915 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkohet një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

**Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

